



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 17, Tetor 2015

ISSN 2225-2959



**HUAMARRIM
VENDORORE**

**Një faqe e re apo
vazhdimësi?**



OBJEKTIVAT GLOBALE

Për Zhvillimin e Qëndrueshëm

ËSHTË KOHA PËR TË NDRYSHUAR BOTËN

THUAJAÇDONJERIU

ANËTARËT E AAB

 ALPHA BANK	 BKT BANKA KOMBETARE TREGTARE	 CREDINS bank	 CBA CREDIT BANK OF ALBANIA BANKA E KREDITIT E SHQIPERISE
 CRÉDIT AGRICOLE	 Fibank First Investment Bank	 INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK rëndësi kanë vlerat	 INTESA SANPAOLO BANK Albania
 NBG Bank	 ProCredit Bank	 Raiffeisen BANK	 SOCIETE GENERALE ALBANIA
 TIRANA BANK	 UNIONBANK	 UBA Banka e Bashkuar e Shqiptarise United Bank of Albania	 VENETO BANKA GRUPPO VENETO BANCA

Përmbajtja



HUAMARRJA VENDORE

Një faqe e re apo vazhdimësi?

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

Nr.17, Tetor 2015
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Editorial

Huamarrja vendore
Një treg për t'u zhvilluar dhe për të marrë pjesë
Elvin MEKA

Tema e Ditës

Huamarrja vendore, instrument zhvillimi
Erjon VELIAJ
Reforma territoriale, mundësi të reja për
huamarrje vendore
Majlinda KULLAJ
Financimi për qeverinë vendore
Mundësi për bankat
Admira MLIKA
Për një huamarrje eficiente të qeverisë vendore
Sabina LALAJ, Ened TOPI

Intervista

Procredit Bank Albania
Eksperienca gjermane në tregun bankar shqiptar
Adela LEKA

Banking System

NMV-të në Shqipëri
Kush do t'i kreditojë ato?
Anila MUÇMATA
Nënshkrimi elektronik
Rëndësia dhe përparësitë e tij
Edlira LLANGO
Mundësi të reja për lehtësimin e shërbimeve online
Adrian HASA

Forumi i Ekspertëve

Fshirja e huave në sistemin bankar shqiptar
Çfarë vjen më pas?
Alexander ZSOLNAJ

Këndi i Ekonomistit

Bankat greke përballë krizës
Efektet dhe masat në Ballkan dhe Shqipëri
Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria Sociale

Veprimtaritë e Bankave

Teknologji

How Credit Card Work
How to benefit from an Installment Plan
Monika BALLTA

Auditori Financiar

Banka Aziatike e Investimeve në Infrastrukturë (AIIB)
Një faktor i ri për zhvillim ekonomik rajonal e global
Roberto RUOZI

Junior Achievement

Kontributi i biznesit në edukimin e sipërmarrësve të së ardhmes

ICC Albania

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

AAB Aktivitete

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtorë
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: FCB Afirma

Printed by: Gent-grafik

BORDI EDITORIAL:

- Christian CANACARIS
9 Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank Shqipëri
- Gazmend KADRIU
15 Nënkryetar i i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Union Bank
- Periklis DROUGKAS
16 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania
- Seyhan PENCABLIGIL
18 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Banka Kombëtare Tregtare
- Frédéric BLANC
21 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Societe Generale Shqipëri
- Bozhidar TODOROV
26 Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm i Fibank Shqipëri
- Endrita XHAFERAJ
30 Sekretare e Përgjithshme, Shoqata Shqiptare e Bankave
- Hysen ÇELA
34 Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
- Adrian CIVICI
37 President i Universitetit European të Tiranës
- Spiro BRUMBULLI
39 Drejtor i kabinetit të Ministrisë të Financave
- Enkeleda SHEHI
41 Drejtore Ekzekutive e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare
- 42

DEPOZITË "BONUS"

SHTONI PËRFITIMET TUAJA!

24 = 26

12 = 13

Një muaj interes bonus, për depozitën tuaj 12 mujore
dhe dy muaj interes bonus, për depozitën tuaj 24 mujore

Oferta është e vlefshme:

- për investimet në Lekë dhe në Euro
- nga 20 Gusht deri në 20 Shtator 2015
- për shuma që fillojnë nga 500,000 Lek & 5,000 EUR



NBG Bank



nga Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

"Ndërtimi i qyteteve të qëndrueshme - dhe i një të ardhmeje të qëndrueshme - shtron nevojën për hapjen e një dialogu midis gjithë niveleve të qeverisë qendrore, rajonale e vendore. Gjithashtu, ajo do të kërkojë angazhimin e gjithë grupeve të interesit - përfshirë sektorin privat dhe shoqërinë civile, veçanërisht të varfrit dhe shtresat e marginalizuara". Kjo shprehje e Z. Ban Ki-moon në *"Ditët e qyteteve të qëndrueshme"*, organizuar nga OKB-ja në 2013-ën, ravigjeron sfidën madhore, me të cilën përballen qytetet dhe zonat urbane në të ardhmen, sfidë kjo edhe për Shqipërinë, që ka nevojë të trajtohet me vëmendje dhe ashtu siç duhet.

Në këtë kuadër, reforma e re administrativo-territoriale mund të konsiderohet si një gur kilometrik, për menaxhimin dhe administrimin më të mirë të territorit. Ndoshta, kjo nuk është përpjekja e parë për hartimin e një kuadri ligjor funksional për pushtetin vendor, por është e sigurt që kjo reformë i ka të gjitha mundësitë të bëhet sipërmarrja e parë madhore, në drejtim të vënies së qeverisë vendore në shina qeverisjeje moderne e mirë-funksionale. Për shumë vite me

Huamarrja vendore

Një treg për t'u zhvilluar dhe për të marrë pjesë



Njësitë e reja të qeverisjes vendore duhet të kuptojnë se fondet që do marrin hua duhet t'i transformojnë në një vlerë të shtuar afatgjatë për komunitetin të cilit i shërbejnë, nga i cili janë zgjedhur, e kundrejt të cilit janë plotësisht përgjegjës dhe të përgjegjshëm.



radhë, kemi qenë dëshmitarë të një numri të madh ndryshimesh dhe shtesash në kuadrin ligjor të qeverisjes vendore, të cilat janë përdorur zakonisht si një kalë beteje në politikën e përditshme dhe rrallë për sigurimin e një ecurie më të mirë dhe fuqizimin e njësisë të qeverisjes vendore, në drejtim të ofrimit të shërbimeve më të mira, përmes buxheteve të qëndrueshme dhe të balancuara.

Është fakt që, i munguari i madh në këtë teatër të qeverisjes vendore ishte niveli gjithmonë i ulët i decentralizimit fiskal, kurse pjesëmarrës i përhershëm ishte atomiciteti i njësisë të qeverisjes vendore. Kjo e fundit tashmë i përket të kaluarës, ndërsa autonomia ka nevojë të vendoset e jetësohet, duke konsideruar praktikatat më të mira, që aplikojnë qeveritë lokale moderne. Sigurisht, decentralizimi i vërtetë do të kërkojë një ndërhyrje të guximshme dhe profesionale në kuadrin ligjor të huamarrjes vendore. Këtu vjen dhe pjesa e bankave, pikërisht në rolin që ato duhet të luajnë siç duhet. Bankat në Shqipëri e kanë mbështetur huamarrjen vendore, që nga fillimi i saj në 2008-ën, si dhe do jenë tejet të interesuara e të gatshme të hyjnë në këtë treg, sapo kuadri i saj ligjor dhe emetuesit të përmbushin e të plotësojnë pritshmëritë dhe analizat e tyre teknike. Sigurisht, përpara qeverisjes vendore dhe bankave e institucioneve të tjera financiare shpalolet një mundësi e

dyanshme në drejtim të zhvillimit dhe përdorimit të tregut të letrave me vlerë të pushtetit vendor, përveç huamarrjes bankare për të. Bankat mund të përfitojnë nga kjo mundësi në të ardhmen, pasi ato kanë burime njerëzore të kualifikuara, kapacitete institucionale, financiare dhe analitike për të administruar dhe financuar të gjithë procesin, që nga huamarrja deri te nënshkrimi dhe tregtimi i letrave me vlerë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, njësitë e reja të qeverisjes vendore duhet të veprojnë në mënyrë shumë të kujdesshme, kur të vendosin të përdorin tregun financiar dhe atë të letrave me vlerë për instrumentet dhe letrat me vlerë të pushtetit vendor, me qëllim shfrytëzimin optimal të mundësive që u ofron aktualisht reforma administrativo-territoriale, ndërkohë që duhet të jenë të përgjegjshëm për fondet që do grumbullojnë në të ardhmen. Ato duhet të kuptojnë se fondet që do marrin hua duhet t'i transformojnë në një vlerë të shtuar afatgjatë për komunitetin të cilit i shërbejnë, nga i cili janë zgjedhur, e kundrejt të cilit janë plotësisht përgjegjës dhe të përgjegjshëm. Ndoshta është koha të rikujtojnë thënien ikonë të Z. Benjamin Franklin: *"Nëse doni të dini vlerën e parave, shkonit dhe merrni një hua!"*

¹ Zv.Dekan & Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET

Huamarrja vendore, instrument zhvillimi



nga Z. Erjon VELIAJ,
Kryetar i Bashkisë Tiranë

BANKIERI: Në pozicionin tuaj si Kryetar i Bashkisë së Tiranës dhe në kuadër të ndarjes së re territoriale, sa sfiduese është për ju situata financiare me të cilën do të përballen në vijim njësitë e reja territoriale dhe konkretisht Tirana, si bashkia më e madhe?

▶ Një nga arsyet kryesore se pse u ndërmor reforma territoriale ishte edhe konsolidimi financiar i njëjësive administrative. Të mos harrojmë se një pjesë e madhe e ish - komunave, apo bashkive, nuk gjeneronin fare të ardhura dhe ishin kthyer në barrë për buxhetin e shtetit. Reforma territoriale dhe ndarja e re administrative u hartua për të mundësuar një efikasitet më të lartë financiar dhe shërbime më cilësore, kështu që nga kjo pikëpamje, situata financiare do të jetë disi më e lehtë si për njësitë administrative, ashtu edhe për buxhetin e shtetit.

BANKIERI: Cili mendoni se do të jetë pozicioni i Bashkisë së Tiranës, lidhur me huamarrjen vendore dhe përdorimin e këtij instrumenti në të ardhmen e afërt dhe të largët?

▶ Pas 4 viteve në letargji, Tirana ka nevojë më shumë se kurrë për zhvillim dhe zhvillimi kërkon investime. Ne do të bëjmë ç'është e mundur, për të gjetur burimin e financimeve për këto investime. Një pjesë do të vijë nga disa rishikime në paketën fiskale lokale, por ama një pjesë duhet të vijë edhe nga huamarrja vendore. Vërtet kriza ekonomike ka bërë që qeveritë ta shohin me një sy tjetër borxhin publik, por gjithsesi nuk duhet mohuar asnjëherë roli që luan borxhi në nxitjen e zhvillimit ekonomik. Ndërsa flasim që qeveria ka një marrëveshje me FMN-në, që e kufizon borxhin publik dhe ndalon akumulimin e mëtejshëm të tij, nuk mund të mohohet që, pas përmirësimit të situatës financiare të vendit, huamarrja, vendore apo qendrore, do të luajë një rol më të rëndësishëm në zhvillimin e Shqipërisë.

BANKIERI: Cilat mendoni se janë vështirësitë dhe pengesat

kryesore drejt sigurimit të një financimi të mjaftueshëm për pushtetin vendor nga ana e bankave, e më tej, nga sistemi financiar shqiptar?

▶ Vështirësitë që mund të hasë pushteti vendor për të siguruar financim nga sistemi financiar besoj se janë të njëjtat me ato që has çdo sipërmarrje në kërkim të një huaje. Tashmë nuk përbën më lajm fakti që sistemi financiar shqiptar ndodhet në vështirësi. Ndonëse depozitat janë rritur, norma e huadhënies vazhdon të mbetet e ulët dhe norma e huave me probleme vijon të jetë e lartë. Mendoj se një zhblllokim i kësaj situatë është ajo që nevojitet në radhë të parë. Pastaj, siç e përmenda edhe më sipër, nevojitet një përmirësim i treguesve financiare të vendit në mënyrë që të lejohet huamarrja. Së fundi, ndarja e re administrative, ashtu siç rrit kompetencat e bashkive duhet t'u mundësojë atyre edhe një autonomi më të lartë financiare, ku sigurisht duhet përfshirë edhe huamarrja lokale.

BANKIERI: Si e shikoni bashkëpunimin e Bashkisë së Tiranës dhe sistemit bankar, në kuadër të ridimensionimit të skemës së financimit të pushtetit vendor në Shqipëri?

▶ Pikë së pari, më lejoni t'ju them se unë nuk shoh asnjë arsye se pse në parim projektet lokale të mos financohen nga bankat lokale. Borxhi publik nuk duhet pasur frikë, por duhet parë si një instrument zhvillimi. Ashtu sikurse një biznes nuk mund të zmadhohet pa huamarrje, ashtu edhe një institucion vendor nuk mund të realizojë të gjitha projektet në shërbim të komunitetit pa investime. Jam i mendimit se në të ardhmen duhet që huamarrja nga pushteti vendor të luajë një rol më të rëndësishëm se deri tani. Shtysë për këtë, përveç politikëbërësve, duhet të marri edhe sektori bankar, nëpërmjet zhvillimit të produkteve të reja dhe novatore të financimit për zhvillimin lokal.



nga Dr. Majlinda KULLAJ

Pedagoge
FAKULTETI I EKONOMISË DHE
AGROBIZNESIT
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Objektivi kryesor i reformës territoriale të vitit 2015 synon të shmangë inefiçencën e kryerjes së shërbimeve publike në nivel vendor, që vinte kryesisht nga fragmentimi i madh i territorit dhe numri shumë i madh i njësive të qeverisjes vendore (NJQV). Ndonëse ndarja e re territoriale mbështetet në parimin e “zonave funksionale”, në tërë dokumentacionin e prodhuar në kuadrin e kësaj reforme gjen shumë pak analizë se si kjo ndarje e re do të prodhojë zhvillim të territorit nëpërmjet sipërmarrjes private. Kjo, në kushtet kur pesha relative e qeverisjes vendore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe ndaj shpenzimeve buxhetore (ShB) gjithsej mbetet relativisht e ulët, me rreth 2.9% dhe 10.2%, përkatësisht në vitin 2012, raporte këto që kanë

Reforma territoriale, mundësi të reja për huamarrjen vendore



Zgjerimi i huamarrjes vendore do të çonte drejt një përmirësimi të rolit të bankave në zhvillimin ekonomik të territorit, duke financuar investime që lidhen me shërbime publike, infrastrukturën urbane dhe rurale, e madje edhe infrastrukturën bujqësore, çka është parakusht për zhvillimin e bujqësisë.



rënë që nga viti 2009 (4.7% ndaj PBB dhe 14.2% ndaj ShB). Pavarësisht rritjes së të ardhurave të krijuara nga burimet e veta dhe shfrytëzimit të burimeve të reja, autoriteti fiskal mbetet i dobët dhe varësia nga burimet kombëtare e lartë. Kësisoj, edhe bashkitë e reja do të vazhdojnë të kenë mungesa të mëdha burimesh për investime, veçanërisht për ato që kërkojnë kapitale të mëdha. Nga ana tjetër, Ministria e Financave ka ndërmarrë politika shtrënguese fiskale, për t'i bërë ballë krizës ndaj dhe nuk pritet të kenë rritje domethënëse të fondeve për zhvillimin e rajoneve.



Në kushtet e tkurrjes së huadhënies ndaj individëve dhe bizneseve gjatë viteve të fundit, bankat duhet të shohin huamarrjen vendore si një çlirim të fondeve të tepërta. Për bankat, bashkitë janë klientë të mirëpritur, për shkak të rrezikut të ulët të huadhënies, sepse garancia konsiderohet deri diku sovrane.

Të gjendur përballë nevojës së ngutshme për investime në raport me pritshmëritë e publikut, 61 bashkitë e mëdha do të rrisin trysinë e tyre ndaj qeverisë, për të rritur transfertën ndërqeveritare, rritur taksat e njëkohësisht për të marrë hua nga bankat tregtare. Siç u përmend dhe më lart, në kushtet e një rritje ekonomike të dobët dhe borxhi publik të lartë nuk priten rritje të ndjeshme të transfertës, e cila që pas vitit 2010 ka pësuar rënie (me një rritje të vogël në vitin 2014). Edhe një shtesë e grantit prej 80 milionë euro, që kursehen për shkak të reformës territoriale, e shpërndarë në 61 bashki, nuk mund të përmbushë nevojat e këtyre të fundit për investime. Nga ana tjetër, qeveria qendrore dëshiron të shmangë rritjen e taksave vendore nga bashkitë dhe pritet që edhe me ligjin e ri për qeverisjen vendore të ruajë kufizimin e autonomisë fiskale. Ndërkohë, edhe bashkitë janë të ndërgjegjshme se ka ende rezerva në zgjerimin e bazës së tatueshme, për shkak të informalitetit të lartë, por jo një nivel veprimtarie ekonomike e atillë që mund të tatohet më shumë. Pra, ndonëse motivimi i qeverisjes vendore është të përfitojë grante se sa të marrë hua, kjo e fundit duket si alternativa që ka më shumë potencial për



zgjerim. Në këto kushte, do të duhet që qeveria të rishikojë shkallën e kontrollit të huamarrjes vendore, e ndërgjegjshme që urdhrat administrative për kufizimin e autoritetit huamarrës për efekt të ruajtjes së niveleve të borxhit publik, kanë çënuar me tepër potencialin financiar të njërive të qeverisjes vendore. Për më tepër që, borxhi i qeverisjes vendore në borxhin e përgjithshëm publik nuk i kalon 0.020%, çka përbën një argument të fortë pro huamarrjes vendore. Bashkëveprimi i këtyre tre faktorëve: kufiri i huas, madhësia e grantit, dhe taksat vendore, do të jenë një negociim i ndërlikuar midis qeverisë dhe bashkive, për më tepër nëse këto negociime janë individuale për çdo bashki.

Në kushtet e tkurrjes së huadhënies ndaj individëve dhe bizneseve gjatë viteve të fundit, bankat duhet të shohin huamarrjen vendore si një çlirim të fondeve të tepërta. Për bankat, bashkitë janë klientë të mirëpritur, për shkak të rrezikut të ulët të huadhënies, sepse garancia konsiderohet deri diku sovrane. Pavarësisht “garancisë” ligjore të mos-falimentimit, si për çdo klient, bankat ia nënshtrajnë huadhënien një analizë rreziku dhe, në rastin e bashkive, shpresojnë gjithnjë në një garanci shtesë në raport me klientët e tjerë. Një përparësi e rëndësishme e bashkive të mëdha është përmirësimi i aplikimeve për hua, të mbështetura me studime të përfutueshmërisë, për shkak të rritjes së numrit të specialistëve të nivelit të lartë të punësuar në to. Në të njëjtën kohë, përmirësimi i planeve më të mira të investimit dhe buxhetimit do t’i ndihmojë bashkitë ta shohin borxhin si një instrument për të përmirësuar pozitën e tyre dhe jo si një evidencë sikletosëse e dobësisë së tyre financiare. Rrjedhimisht, do të ketë një numër më të madh aplikimesh për hua, të cilat e kalojnë pozitivisht analizën e rrezikut nga ana e bankave. Po kështu, rritja e ecurisë së personelit të bashkive të mëdha do të përmirësojë informacionin që kërkohet nga bankat, për të ushtruar kontroll financiar mbi buxhetet bashkiake. Zgjerimi i huadhënies vendore do të çojë në përsosjen e sistemeve të bankave tregtare për vlerësimin e huadhënies për bashkitë,

d.m.th. aftësinë e tyre për të shlyer detyrimet.

Rishikimi i kufizimeve ligjore mbi huamarrjen afatgjatë vendore mund të shërbente për të debatuar sërish mbi qasjen e qeverisë shqiptare lidhur me të, duke shkuar drejt një modeli më liberal, si: praktika e Hungarisë apo Estonisë. Nëse qeveria qendrore i jep të drejtë vetes për të rritur huamarrjen në tregun ndërkombëtar, e rrjedhimisht borxhin publik, me qëllim kryerjen e investimeve, përmirësimin e shërbimeve, etj., e njëjta liri u duhet dhënë edhe bashkive për të njëjtat qëllime. Në veçanti, duhet të rishikohet niveli i stokut të borxhit dhe i shërbimit të borxhit pasi, në nivelin aktual, janë tejet kufizues për huamarrjen vendore. Gjithashtu ka vend për të zgjeruar gamën e garancive të huas, duke marrë modele të vendeve si: Sllovakia apo edhe garancitë nga palë të treta, si në rastin e Republikës Çeke.



Ndonëse motivimi i qeverisjes vendore është të përftojë grante se sa të marrë hua, kjo e fundit duket si alternativa që ka më shumë potencial për zgjerim. Në këto kushte, do të duhet që qeveria të rishikojë shkallën e kontrollit të huamarrjes vendore, e ndërgjegjshme që urdhrat administrative për kufizimin e autoritetit huamarrës për efekt të ruajtjes së niveleve të borxhit publik, kanë çënuar më tepër potencialin financiar të njërive të qeverisjes vendore.



Rishikimi i kuadrin ligjor mund të zgjerohej edhe në legjislationin bankar. Konkretisht, mund të rivlerësohej rreziku i besueshmërisë nëpërmjet rishikimit të koeficientëve të rrezikut, për t’i inkurajuar bankat t’i shohin bashkitë si huamarrës

të mirë. Pra, mund të konsiderohet ulja e faktorit të rrezikut që lidhet me borxhin e qeverisë vendore, që përdoret për llogaritjen e kërkesave të normës së rezervës së bankave individuale. Rishikimi i dispozitave rregullatore mund të rrisë më tej interesin e bankave tregtare në sektorin e qeverisjes vendore. Pavarësisht nevojës për ndryshime ligjore, këto të fundit nuk duhet të zbatohen nga çdo qeveri e rradhës, pasi krijon një paparashikueshmëri të sistemit financiar ndërqeveritar, e rrjedhimisht kjo pasiguri do t’i shtyjë bankat të kërkojnë një prim rreziku më të lartë për huat që u japin bashkive.

Zgjerimi i huamarrjes vendore do të çonte gjithashtu drejt një përmirësimi të rolit të bankave në zhvillimin ekonomik të territorit, duke financuar investime që lidhen me shërbime publike, infrastrukturën urbane dhe rurale, e madje edhe infrastrukturën bujqësore, e cila është parakusht për zhvillimin e bujqësisë. Për këtë të fundit, huadhënia për investime që përmirësojnë rrjetin e kanaleve ujitëse dhe kulluese, rezervuare apo vepra të tjera të ngjashme, investimet për tregje, qendra grumbullimi, therrtore, etj., përbëjnë instrumente të rëndësishëm për përmirësimin e mjedisit të biznesit bujqësor. Nëse fondi i garancisë i qeverisë për huat e bizneseve për investime në bujqësi mund të zgjerohej për të përfshirë edhe investimet e lartpërmendura nga bashkitë do të ishte një stimul i rëndësishëm në këtë drejtim. Në periudhën afatgjatë, konkurrenca eventuale ndërmjet bankave do të çojë në zhvillimin e instrumenteve të borxhit të projektuara posaçërisht për bashkitë.

Një nismë konkrete dhe e strukturuar do të ishte organizimi i një procesi dialogu dhe këshillimi midis Qeverisë, Shoqatës së Bashkive dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave, me qëllim prezantimin e qëndrimeve dhe sugjerimeve për ndryshime në procedurën e huamarrjes, diskutimin mbi subvencionimin e mundshëm të interesave nga qeveria qendrore, apo çlirimi nga taksimi i tyre, natyra e investimeve të NJQV–ve, etj.



nga Zj. Admira MLIKA

Drejtuese e Departamentit të Kredive
Tregtare dhe Korporatave
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Në tregjet ndërkombëtare huadhënia ndaj Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) është parë relativisht si një veprimtari me rrezik të ulët dhe si një mundësi e mirë për bankat të zgjerojnë veprimtarinë me njësinë vendore, duke përfshirë depozitat, menaxhimin e cash-it e shumë produkte të tjera. Historikisht, huat ndaj qeverisjes qendrore apo vendore janë menduar si një mundësi kreditimi pa rrezik, për arsye të pagesave të garantuara, bazuar kryesisht në të ardhurat nga taksat dhe tarifatat. Ndërkohë, kriza financiare dhe pasojat e saj vendosën mjaft pikëpyetje mbi qëndrueshmërinë e situatës financiare të këtyre njësive, duke i bërë si asnjëherë shlyerjet e detyrimeve financiare më pak të sigurta.

Por si është situata në Shqipëri? Gjatë gjithë këtyre viteve, Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë kaluar përgjatë një procesi të rëndësishëm decentralizimi që përfshinte ristrukturimin dhe transformimin në disa sektorë njëkohësisht. Qëllimi i këtij procesi ishte dhënia e burimeve dhe

Financimi për qeverinë vendore

Mundësi për bankat



Me ndarjen e re territoriale mundësitë për bankat në drejtim të financimit të nevojave të pushtetit vendor janë më të larta, pasi riorganizimi pritet të sjellë një menaxhim më të mirë të të ardhurave dhe shpenzimeve.



zhvillimi i kapaciteteve të mjaftueshme të Njësive Vendore, me qëllim që ato të realizojnë funksionet për të cilat janë përgjegjëse. Transformimi përfshinte tre dimensione: (i) nivelin institucional; (ii) transferimin e kompetencave fiskale dhe legjislativin përkatës për këtë, si dhe (iii) aspektin financiar. Procesi i huamarrjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore daton që prej 4 shkurtit 2008, me miratimin e ligjit nr.9896: “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”, që u siguroi Njësive të Qeverisjes Vendore mundësinë e huamarrjes në tregun financiar, për të mbështetur nevojat e tyre financiare me

qëllim ushtrimin e funksioneve të tyre ekskluzivë. Ky ligj përcaktoi qartë kufijtë e huamarrjes nga njësia e pushtetit vendor, garancitë, procedurat e aplikimit, përlllogaritjen e kufijve minimalë dhe kriteret e borxhit, si dhe raportimin pranë Ministrisë së Financave.

Sigurisht, për një fushë të paeksploruar më parë, në kushtet kur pas vjeljes së taksave dhe tarifave, mundësia e vetme ishin grantet, donatorët e jashtëm dhe mbështetja me fondet e buxhetit, ky instrument ka një rëndësi të veçantë për vetë kontekstin në të cilin ndodheshin financat vendore. Thënë ndryshe, ky ligj u ofron njësive të qeverisjes vendore më shumë mundësi financiare për të zgjidhur probleme urgjente, apo për të realizuar investime të rëndësishme për komunitetin, si për nga natyra ashtu dhe madhësia. Gjithashtu, shoqëruar kjo me kërkesat specifike, lidhur me plotësimin e kriteret të huamarrjes, ndërveprimin me aktorët e interesuar nga tregu financiar për t’u bërë palë në këtë proces, siç janë: auditimi i bilanceve financiare të NJQV-ve, përgatitjen e projekteve të fizibilitetit si dhe hapjen e procesit të huamarrjes për të gjithë komunitetin sjell një faqe të re, duke forcuar më tej njësitë vendore si dhe rritur kapacitetet financiare, transparencën dhe çka është më e rëndësishmja, përgjegjshmërinë e tyre.



NJQV-të e reja, tashmë të riorganizuar, duhet të tregojnë se janë të afta të menaxhojnë me përgjegjshmëri taksat dhe tarifatat e komunitetit të tyre; janë të afta të vlerësojnë përparësitë në marrjen e vendimeve të investimeve urgjente apo strategjike dhe janë duke përmirësuar dukshëm transparencën në vendimmarrje.



Përmbledhtazi, kushtet që duhet të përmbushin NJQV-të janë si më poshtë:

- NJQV-ja mund të marrë hua afatgjatë në atë nivel sa stoku total i borxhit afatgjatë të mos kalojë raportin 1.3:1 ndaj të ardhurave operative (që përfshijnë gjithsej: të ardhurat nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuara).

- Raporti i tepricës operative të vitit fiskal paraardhës (llogaritur si diferencë e të ardhurave operative, minus shpenzimet operative jo të kushtëzuara) me shërbimet vjetore të borxhit afatgjatë, duhet të jetë jo më pak se 1.4:1.

- Shërbimi vjetor i borxhit nuk duhet të kalojë 20% të buxhetit total të të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuara, taksat dhe tatimet e ndara dhe taksat e tarifave vendore, përlllogaritur për tre vitet fiskalë paraardhëse të NJQV-së.

Ndërkohë, mjaft të rëndësishëm janë edhe hapat e procesit, të cilët përfshijnë:

Fazën Përgatitore nga ana e NJQV-së, duke filluar nga: analiza e nevojës për financim; përgatitja e plan-veprim-it; informimi i Ministrisë së Financave; dërgimi i letrave për shprehjen e interesit në këtë financim nga ana e bankave, duke vijuar më tej me dërgimin e informacionit paraprak të nevojshëm pranë këtyre institucioneve.

Marrëdhëniet me bankat: vlerësimi i ofertave në një proces tenderimi të hapur; negocimi me bankat dhe përzgjedhjen e bankës që ofron paketën me kushte më të mira; hartimi i marrëveshjes mes palëve.

Miratimin e huas: miratimi i huas dhe kushteve të saj në Këshillin e NJQV-së; më pas vijohet me miratimin nga Ministria e Financave të përlllogaritjes dhe përputhshmërisë së huas me kriteret ligjorë dhe kufizimet financiare, si dhe verifikimin nëse janë respektuar procedurat, duke vazhduar më tej me siglimin e kontratës me bankën e përzgjedhur.

Përdorimin e huas: disbursimi i shumës së huas; regjistrimi pranë Zyrës së Thesarit; përdorimi sipas fazave të investimit; raportimi pranë Këshillit të NJQV-së dhe Drejtorisë së Borxhit pranë Ministrisë së Financave.

Një nga aktorët më të rëndësishëm

të procesit të huamarrjes janë bankat, si pala që siguron financimin. Ligji aktual për "Huamarrjen e Qeverisjes Vendore" është një hap i parë drejt shtimit të kapaciteteve financiare të qeverisjes vendore, për të realizuar projekte investimi, të cilat janë të pamundura për t'u realizuar me anë të buxhetit vjetor të saj. Për sistemin bankar kjo do të thotë një



Historikisht, huat ndaj qeverisjes qendrore apo vendore janë menduar si një mundësi kreditimi pa rrezik, për arsye të pagesave të garantuara, bazuar kryesisht në të ardhurat nga taksat dhe tarifat. Ndërkohë, kriza financiare dhe pasojat e saj vendosën mjaft pikëpyetje mbi qëndrueshmërinë e situatës financiare të këtyre njësive, duke i bërë si asnjëherë shlyerjet e detyrimeve financiare më pak të sigurta



mundësi e re zgjerimi dhe mbështetje e këtyre projekteve, brenda një kuadri ligjor të mirë-rregulluar. Ndërkohë që, duke konsideruar frymën konservatore të këtij ligji, krahasuar me vendet e tjera, pritisshmëria për sa i përket rrezikut të moskthimit të huave të njësive vendore vlerësohet të jetë e ulët. Megjithatë, sfidat dhe problematikat e hasura ishin të shumta. Shumica e institucioneve financiarë nuk kishin një informacion të saktë për vlerësimin e kapaciteteve financiare të njësive vendore dhe zakonisht metodat e përdorura nga bankat ishin hartuar për të vlerësuar shoqëritë private dhe jo njësitë e Qeverisjes Vendore, ndaj dhe mungesa e një informacioni dhe kapaciteteve të tilla analizuuese vetëm e vështirësonte procesin e huamarrjes.

Banka Kombëtare Tregtare, në

bashkëpunim me USAID, si një prej pjesëmarrësve në Programin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA), që përveç mbështetjes në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve huadhënëse ofronte edhe një fond garancie në masën 50% për një shumë të caktuar të huas për disa njësi të qeverisjes vendore të përzgjedhura, nisi financimin e tyre në shtator të vitit 2010. Sfidat me të cilat përballëj banka ishin nga më të ndryshmet, duke filluar që nga fakti që njësitë vendore ishin disi të paqarta në këtë proces dhe stafet e tyre teknike kishin vështirësi në përgatitjen dhe paraqitjen e projekteve të fizibilitetit dhe të të dhënave financiare, me qëllim përlllogaritjen e saktë të kriterëve të borxhit, deri në kufizimet e vendosura nga Ministria e Financave, duke filluar që nga viti 2011, për lëvrimet vjetore të fondeve të huas. Pra, pavarësisht nëse një NJQV i përmbushte të gjitha kriteret ligjore dhe paraqiste një gjendje financiare të shëndetshme që mund të përballonte të gjithë huan, kufizimet e vendosura nga Ministria e Financave kushtëzonin dhe zgjasnin në kohë përfundimin e projektit, për të cilin po merrej huaja. Duke qenë se lëvrimet vjetore të huas ishin në nivele mjaft të ulëta, USAID vendosi të ndërprejë programin e garancisë në prill 2012, duke mbajtur të përfshira ato raste tashmë të disbursuara. Nga ana tjetër, banka me ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj dhe njohjen e tregut gjatë kësaj kohe, vazhdoi të ishte një nga bashkëpunëtorët kryesorë në mbështetjen dhe financimin e projekteve ekonomike të pranueshme të Njësive të Qeverisjes Vendore, duke marrë si të vetmen garanci "të ardhurat e pakushtëzuara", nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes së Interceptimit.

Decentralizimi i Njësive Vendore (nga 373 njësi të Qeverisjes vendore në 61 bashki), ndikon në ndryshimin e të gjitha të dhënave, të tilla si: popullsia, niveli i të ardhurave, niveli i shpenzimeve, projektet etj., të cilat janë riorganizuar sipas ndarjes së re administrative dhe territoriale. Sigurisht, kjo kërkon kohën e saj, por në tërësi do të thotë një menaxhim më i mirë i të ardhurave dhe shpenzimeve. Gjithashtu, njësitë

vendore ekzistuese tashmë përfshijnë një territor më të madh, ndërkohë që në huat ekzistuese është bërë analiza e një territori të caktuar, gjë që ndikon tani në gjendjen financiare të të gjithë territorit dhe në likuidimin e huas. Në këto kushte, do të sugjerohej forcimi i kapaciteteve të brendshme të auditimit të NJQV-ve dhe identifikimi i problemeve të kontabilitetit në nivel vendor. Gjithashtu, të gjitha kriteret, kufizimet, kushtet, zërat që përfshihen, procedurat që duhet të plotësohen nga NJQV-të duhet të jenë të specifikuar qartë në manuale, të mund të ofrohen trajnime të stafeve teknike të NJQV-ve (ndërkohë që qëndrueshmëria e këtyre stafeve është mjaft e rëndësishme), lidhur me përgatitjen dhe përlllogaritjen saktë të kriteve ligjore dhe financiare si dhe të rritit transparencë. Këto njësi, tashmë të rior-

ganizuara, duhet të tregojnë së janë të afta të menaxhojnë me përgjegjshmëri taksat dhe tarifat e komunitetit të tyre; janë të afta të vlerësojnë përparësitë në marrjen e vendimeve të investimeve urgjente apo strategjike dhe janë duke përmirësuar dukshëm transparencën në vendimmarrje. Nga ana tjetër, me qëllim rritjen e mundësisë së huadhënies, mund të shikohet mundësia edhe e ofrimit të garancive në formën e pasurive të patundshme, për të cilat të ketë rregulla të specifikuar qartë në termat e pranueshmërisë dhe specifikave, në rast përmbarimi.

Me ndarjen e re territoriale mundësitë për bankat në drejtim të financimit të nevojave të pushtetit vendor janë më të larta pasi, sikurse u përmend më lart, riorganizimi pritet të sjellë një menaxhim më të mirë të të ardhurave dhe shpen-

zimeve. Kjo kërkon gjithashtu një qasje rigorozë në drejtim të përzgjedhjes së projekteve ekonomikisht të pranueshme, me kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e jetës së komunitetit. Nga ana tjetër, për bankat kjo është një mundësi mjaft e mirë e zgjerimit të portofolit të tyre në huadhënie, të cilat konsiderohen me rrezik të ulët si dhe në krijimin e një vlere të shtuar nëpërmjet kontributit të saj në zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e punësimit.

Në nivel bashkëpunimi dhe në funksion të përgjegjësisë sociale, me qëllim të kontribuojë sa më shumë në rritjen e mirëqenies dhe zhvillimin e vendit, brenda një kuadri të ri më të mirëorganizuar e më transparent, sistemi bankar gjithmonë do të jetë i prirur për zhvillimin e një tregu efektiv të instrumenteve të huamarrjes vendore.



Para kryerjes së çfarëdo vlerësimi të instrumenteve të huamarrjes në dispozicion të qeverisë vendore në Shqipëri dhe rritjes së eficiencës në përdorimin e tyre, është e nevojshme të fillohet me prezantimin e reformës së fundit territoriale dhe administrative të zbatuar në vend. Përshkrimi i peisazhit territorial dhe administrativ e ndihmon lexuesin të kuptojë mekanizmin e huamarrjes së qeverisë vendore dhe të ketë një pamje më të plotë të tij. Në vijim të pjesës hyrëse, ky artikull synon të trajtojë mënyrën se si qeveria vendore mund të përdorë në mënyrë eficiente financimet e marra.

Qeveria Shqiptare ndërmoi një reformë të rëndësishme administrativo-territoriale, e cila i dha një pamje të re hartës së qeverisë vendore. Duke filluar nga zgjedhjet e fundit vendore Republika e Shqipërisë është e ndarë në 61 bashki, tanimë të mëdha, si dhe 12 qarqe. Arsyeja nxitëse e reformës besohet se ishte krijimi i bashkive të mëdha (ose super-bashkive si: Tirana) me një administratë vendore eficiente, megjithëse me një numër më të madh punonjësish, që do të mundësojë ofrimin e shërbimeve më cilësore. Reforma e sipërpërmendur filloi dhe u shoqërua me ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor që rregullon qeverinë vendore. Reforma administrative në Republikën e Shqipërisë filloi me miratimin e ligjit nr. 115/2014: “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji u miratua nga Kuvendi në 31 korrik 2014 dhe hyri në fuqi në 16 shtator 2014, pas publikimit në Fletoren Zyrtare. Ndryshime të tjera në legjislacionin e qeverisë vendore u miratuan në vijim nga Kuvendi, përfshirë këtu dhe ligjin nr. 30/2015, i cili ndryshoi ligjin 8652/2000: “Për organizimin dhe funksionimin e



Zj. Sabina LALAJ
Drejtuuese e Departamentit Ligjor
DELOITTE ALBANIA SHPK



Z. Ened TOPI
Këshilltar Ligjor
DELOITTE ALBANIA SHPK

Për një huamarrje eficiente të qeverisë vendore

Mjetet ligjore për një administrim më të mirë të taksave janë tashmë në duart e administratorëve vendorë, të cilët duhet të ndërmarrin reforma të menjëhershme, me synim përmirësimin e situatës financiare të njësive që qeverisin dhe rritjen e besueshmërisë në sytë e kreditorëve.

qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Duke mbyllur këtu përshkrimin e ndryshimeve thelbësore në hartën administrativo - territoriale të vendit dhe duke kthyer vëmendjen në çështjen e huamarrjes vendore, duhet të përmendim se aktet kryesore që rregullojnë huamarrjen e qeverisë vendore janë ligji nr.9869, datë 04.02.2008: “Mbi huamarrjen e qeverisë vendore” dhe ligji nr.10158, datë 15.10.2009: “Për obligacionet e shoqërive aksionare dhe të qeverisë vendore”. Sipas dispozitave të ligjit 9869/2008, njësitë

e qeverisë vendore mund të kërkojnë në treg marrjen e huave afatgjata, ose afatshkurtra, si për qëllime investimi (huat afatgjata), ose për të përballuar mungesën e përkohshme të likuiditetit (huat afatshkurtra). Qeveria vendore mund të kërkojë në tregjet financiare, apo nga institucionet financiare hua, si në monedhën vendase ashtu dhe në atë të huaj, me normë interesi fikse ose të ndryshueshme. Për sa i takon mënyrës për të kërkuar dhe marrë huat, të dy format e huamarrjes, qoftë ajo afatshkurtër

apo afatgjatë, janë në një mënyrë të kushtëzuara nga miratimi i Ministrisë së Financave. Në rastin e huas afatshkurtër, njësia e qeverisë vendore duhet të presë deri në marrjen e “përgjigjes negative” nga Ministria e Financave, ku të përcaktohet se buxheti i shtetit nuk do të mbulojë nevojat për likuiditet të kësaj njësie. Në lidhje me huan afatgjatë Ministri i Financave ka fjalën e fundit për miratimin, në rastet kur huaja do të sigurohet nga tregjet ndërkombëtare, ose do të merret me qëllim ri-financimin e një huaje të mëparshme, apo kur njësia vendore huamarrëse ka pasur raste të vështirësive financiare në pesë vitet e fundit. Në këtë rast miratimi i Ministrisë së Financave është vendim-marrës. Në raste të tjera, përveç atyre të përmendura më lart, miratimi i Ministrisë së Financave kufizohet në zbatimin e procedurave për autorizimin dhe verifikimin e kufijve të huas, siç përcaktohet në dispozitat e ligjit të sipërpërmendur për huamarrjen vendore. Në asnjë rast miratimi i Ministrisë së Financave nuk mund të konsiderohet si një garanci shtetërore e Republikës së Shqipërisë për mbështetjen e huamarrjes së qeverisë vendore.

Në kushtet e mungesës së garancisë shtetërore për të mbështetur huamarrjen e qeverisë vendore, duhen marrë në konsideratë çështjet e mëposhtme. Qëllimi i legjislatorit është që kreditorët të ndërmarrin gjithë masat e nevojshme për arkëtimin e borxhit, në rast mos-shlyerje nga ana e huamarrësit. Nga ana tjetër, deri më sot, njësitë e qeverisë vendore nuk mund të jenë subjekt i procedurave të falimentimit apo riorganizimit sipas ligjit në fuqi për falimentimin. Vlen për t'u përmendur fakti se, projektligji për falimentimin, tashmë në shqyrtim, parashikon mundësinë e riorganizimit të njësive të qeverisë vendore. Megjithatë, në kushtet aktuale asnjë kreditor nuk mund të kërkojë rikuperimin e borxhit nëpërmjet procedurave të falimentimit. Pra, kreditorët do të ishin më të gatshëm të financojnë huamarrës të besueshëm, që gëzojnë një nivel të pranueshëm pavarësie dhe stabiliteti financiar.

Si përmendëm dhe më lart, njësitë

e qeverisë vendore kanë të drejtën të emetojnë obligacione, në përputhje me dispozitat e ligjit 10158/2009, një formë tjetër kjo për sigurimin e financimit nëpërmjet huamarrjes nga qeveria vendore. Në mënyrë të ngjashme me marrjen e huave, qeveria vendore mund të emetojë obligacione afatshkurtra dhe afatgjata, të cilat detyrimisht duhet të mbështeten nga plani përkatës i huamarrjes, i audituar nga një auditor i jashtëm i licencuar. Pas evidentimit të mundësive të financimit të qeverisë vendore të rregulluara nga legjislacioni në fuqi, më poshtë paraqiten disa vlerësime për rritjen e mundësive të financimit nëpërmjet huamarrjes dhe përdorimit eficient të saj. Fillimisht vlen të përmendet se, bashkitë e mëdha që u krijuan pas zgjedhjeve vendore janë më tërheqëse për kreditorët. Gjithashtu, duhet përmendur se këto njësi të reja të qeverisë vendore duhet të fitojnë apo rikthejnë besimin e kreditorëve. Kjo mund të realizohet nëpërmjet disiplinimit të financave dhe administrimit eficient të taksave, si në procesin e identifikimit, mbledhjes dhe të shpenzimit të arkëtimit. Për sa i takon administrimit eficient të taksave ka ende shumë për t'u bërë nga njësitë e qeverisë vendore. Mbetet pjesë e diskutimeve të vazhdueshme publike se aktualisht niveli i arkëtimit të taksave është shumë i ulët, gjendje që faktohet dhe më tej nga nisma e ndërmarrë nga qeveria për formalizimin e biznesit. Mjetet ligjore për një administrim më të mirë të taksave janë tashmë në duart e administratorëve vendorë, të cilët duhet të ndërmarrin reforma të menjëhershme me synim përmirësimin e situatës financiare të njësive të qeverisë dhe rritjen e besueshmërisë në sytë e kreditorëve. Në momentin kur njësitë e qeverisë vendore krijojnë një nivel besueshmërie të konsoliduar për huamarrjen, institucionet financiare dhe investuesit do të jenë më të gatshëm për t'u përfshirë në financimin e projekteve madhore dhe nismave të qeverisë vendore.

Partneritetet publik-privat janë një formë bashkëpunimi që mund të rrisë besueshmërinë financiare dhe të plotësojë nevojat e qeverisë vendore për investime,

ku ekspozimi financiar shtrihet një periudhë kohore të gjatë. Kjo formë e veçantë bashkëpunimi midis subjekteve publikë dhe privatë, e rregulluar nga ligji nr.125/2013 date 25.04.2013: “Për koncesionet dhe partneritetin publik-privat”, i ndryshuar, ofron dy kushte të favorshme për njësitë e qeverisë vendore, që synon të realizojë investime duke përdorur këtë formë. Në njërin anë, rreziku dhe kostot e menjëhershme të investimit transferohen tek partneri privat dhe në anën tjetër, shlyerja e këtyre kostove shtrihet përgjatë viteve të kontratës së lidhur me partnerin privat, duke shmangur kështu krijimin e detyrimeve me afat të shkurtër ri-pagimi në financat e qeverisë vendore.

Pavarësisht nevojës për përmirësim e përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian, kuadri ligjor në fuqi ofron rregullimin e përshtatshëm për krijimin e një sistemi të huamarrjes vendore dhe rritjes së eficiencës në përdorimin e saj, për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve vendore. Në këto kushte, reforma e filluar me rindarjen administrativo-territoriale duhet të vazhdojë me disiplinimin e financave dhe administrimit eficient të taksave të mbledhura nga qeveria vendore, për të rritur besueshmërinë e njësive vendore përballë huadhënësve, si dhe me shfrytëzimin maksimal të mundësive që ofron kuadri ligjor për mënyrat e huamarrjes dhe përdorimit eficient të tyre.



Pavarësisht nevojës për përmirësim e përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian, kuadri ligjor në fuqi ofron rregullimin e përshtatshëm për krijimin e një sistemi të huamarrjes vendore dhe rritjes së eficiencës në përdorimin e saj, për zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve vendore.





ProCredit Bank

Mbështet prodhimin vendas



ProCredit Bank

Banka juaj partnere



Zj. Adela LEKA

Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive,
PROCREDIT BANK - ALBANIA

Duke marrë parasysh rritjen dhe dinamikat e tregut, si dhe përdorimin e gjerë të teknologjisë në jetën tonë të përditshme ashtu edhe në mënyrën e të bërit biznes, tashmë është fakt që bota fizike dhe ajo dixhitale janë duke u ndërthurur me shpejtësi. Për ne si bankë, jetësimi i teknologjive të fjalës së fundit, vjen si rrjedhojë e nevojës për t'ju përshtatur tregut dhe plotësuar nevojat e klientëve tanë. Për më tepër, kjo vjen dhe si një tipar identifikues, i cili na ka shoqëruar gjatë 2 dekadave operim në tregun bankar shqiptar. Ndaj në kuadër të 20 vjetorit, me shumë kënaqësi prezantojmë për të gjithë klientët tanë një koncept tejet inovativ bankingu, “Zonat 24/7” të vetëshërbimit.

Ky koncept i ri i bankingut u ofron klientëve tanë një shërbim cilësor e në përputhje me nevojat e tyre për shërbime bankare, pa kufizime në kohë, 24 orë në 7 ditë të javës. Në Zonat 24/7 janë të vendosura pajisje të tilla të teknologjisë

Procredit Bank Albania

Eksperienca gjermane në tregun bankar shqiptar



ProCredit Bank vazhdon të sjellë inovacion në sistemin bankar dhe me rastin e 20 vjetorit të saj në Shqipëri prezanton Zonat e Vetëshërbimit 24/7.



së lartë, të cilat u japin mundësi klientëve të kryejnë të gjitha shërbimet bankare rutinë, si: depozitime dhe tërheqje në llogari biznesi apo personale, të kryejnë transfera për palë të treta dhe pagesa të faturave mujore nëpërmjet platformës elektronike e-banking.

Në linjë me strategjinë tonë të Grupit ProCredit, jetësimi i “Zona 24/7” është drejt përfundimit në çdo agjenci tonën, në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Këto zona bankingu trajtojnë si nevojat e klienteve të biznesit, ashtu edhe atyre individë.

Përdorimi i platformës elektronike e-banking rezulton me një prirje shumë pozitive, krahasuar kjo me nivelin e përdorimit për të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjë që demonstroi më së miri prirjen gjithnjë në rritje drejt shërbimeve bankare elektronike. Kjo vjen edhe në përputhje me filozofinë tonë të të bërit biznes, ku ofrimi i shërbimeve moderne bankare janë tejet të rëndësishme për t'i ofruar klientëve tanë transaksione biznesi eficiente, që plotësojnë në kohë nevojat e tyre të biznesit.

Si një bankë tregtare e fokusuar drejt bizneseve SME, ne kemi krijuar të gjithë mjetet e nevojshme për të qenë zgjedhja e parë bankare për këto biznese dhe një partner afatgjatë për realizimin e planeve të tyre të biznesit. Në përmbushje të misi-

onit të bankës, strategjia jonë e biznesit do vijojë të jetë e fokusuar në mbështetjen e atyre bizneseve të cilat janë të mirë-organizuara, kanë struktura të qarta dhe plane investimi, që mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të tyre.

ProCredit Bank - Shqipëri është pjesë e grupit të bankave ProCredit, që operojnë në vende të ndryshme të rajonit. Me qëllim rritjen e bashkëpunimit mes klientëve të bankave ProCredit dhe vendosjen e kontakteve me partnerë potencialë që operojnë në rajon, nëpërmjet organizimit të takimeve rajonale B2B, vëmë në dispozicion të tyre rrjetin e klientëve të bankave rajonale ProCredit. Një rol mjaft pozitiv në nxitjen dhe zhvillimin e lidhjeve të reja të biznesit, po luan dhe banka ProCredit-Gjermani, e cila ka qenë së fundmi mjaft aktive, me takime të zhvilluara në kuadër të kësaj nisme.

Banka ProCredit është një bankë tregtare me kapital 100 % gjerman, e orientuar drejt zhvillimit, e fokusuar në mbështetjen e bizneseve SME. Akcionari ynë i vetëm është ProCredit Bank - Gjermani, me qendër në Frankfurt, Gjermani. Ne mbikëqyremi nga autoritetet të larta të mbikëqyrjes gjermane, si: BundesBank dhe BaFin, të cilët sigurojnë besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë tonë.



nga Zj. Anila MUÇMATA

Drejtoreshë

Departamenti i shitjes dhe suportit të kredisë SIMA, CREDINS BANK

Gjithkush dëgjon në jetën e përditshme që: “Banka nuk ma dha kreditin”, ose “Bankat nuk japin lekë”, duke marrë të mirëqenë faktin që arritje e bankave është mosdhënia e parave, kur logjikisht dhe normalisht funksioni bazë, jetësor dhe kuptimi i qenësisë së bankës është dhënia e huave, pra shitja e fondeve të grumbulluara si depozita, kundrejt një marzhi fitimi të arsyeshëm. Cili dyqan hapet vetëm me qëllimin që shitësi të admirojë mallin e tij, për blerjen e të cilit ka investuar pasurinë e vet, pa patur “dëshirë ta shesë”? Pra, bankat nuk janë në pozitë komode kur i thonë “jo” një klienti, aq më tepër kur këta klientë janë kredikërkuës në shumë relativisht të mëdha, sic janë kërkesat që vijnë nga biznesi i vogël dhe i mesëm.

Në zhargonin e përditshëm dhe atë ekonomik është i njohur nocioni i ciklit

NMV-të në Shqipëri Kush do t'i kreditojë ato?

Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla (NMV) ende vuajnë nga pamjaftueshmëria, ose mungesa totale e kolateralit, shkalla jo e kënaqshme e formalizimit dhe mbajtjes së të dhënave financiare, si dhe mospasja e një plan-biznesi të mirëstrukturuar, i cili do të rriste besimit te bankat.

të jetës, pra: lindja, zhvillimi, pjekuria e më pas rënia. Ky cikël në ekonomitë botërore është më i zgjatur në dekada dhe vite, duke krijuar mundësitë e zhvillimeve dhe rritjes, si të ndërmarrjeve individuale, ashtu dhe të ekonomisë në tërësi, ndërsa në Shqipëri shpesh herë është lëkundur, këputur, rinisur nga fillimi, si rezultat i shumë faktorëve të destabilitetit politik dhe ekonomik, të diskutuar dhe të njohur nga të gjithë.

NMV-të janë baza për zhvillimin e një ekonomie të formalizuar, janë qeliza që priren të krijojnë identitetin dhe kulturën ekonomike të një vendi. Diku si nisma fillestare familjare dhe diku si rezultat i një rritje konstante pasi ka mbijetuar më shumë sakrificat ndër vite, biznesi i vogël dhe i mesëm është e ardhmja e ekonomisë së vendit, që priret të bashkojë bizneset mikro me kapital të papërfillshëm, në biznese me një qëndrueshmëri më të madhe dhe më të strukturuar. Në këndvështrimin e huadhënësit, NMV-të janë mundësia për të rritur dhe diversifikuar portofolin e huas me një shkallë më të moderuar rreziku, të shpërndarë në një bazë më të gjerë biznesesh, duke ulur kështu rrezikun e përqendrimit të portofoleve në disa klientë korporatë. Pavarësisht burimeve natyrore të shumta të vendit tonë vihet

re që përqendrimi dhe kreditimi i NMV-ve është më i madh në sektorët e tregtisë, shërbimit, ndërtimit, hotelerisë dhe shumë me pak në sektorë prodhues, industri nxjerrëse, apo transport e bujqësi. Sado i zhvilluar të jetë sektori i tregtisë së një vendi ai nuk mund të jetë shtylla ekonomike afatgjatë e tij; nuk mund të sjellë zhvillimin e shëndetshëm dhe konstant të tij, pasi nuk prodhon mjaftueshëm vende pune si dhe nuk rrit dukshëm PBB-në e vendit.

Për të dalë logjikisht te moskreditimi i sektorëve të tjerë, kreditimi relativisht më i lartë i tregtisë dhe shërbimeve lidhet me mundësitë financiare të kufizuara të konsumatorëve, që mbulojnë kryesisht vetëm nevojat për produkte bazë për konsum. Po kështu, ndikim kanë dhe politikat importuese shpesh herë me pengesa të ulta për produktet e konsumit që importohen nga shtetet e tjera, duke i favorizuar keto të fundit, por duke



NMV-të janë baza për zhvillimin e një ekonomie të formalizuar, janë qeliza që priren të krijojnë identitetin dhe kulturën ekonomike të një vendi.



penguar prodhimin vendas të plotësojë nevojat e konsumatorit të brendshëm, e aq me pak, për t'u eksportuar. Këtyre vështirësive ju shtohet dhe "skepticismi" i konsumatorit, sidomos për prodhues vendas relativisht të rinj, besimi më i madh te një produkt "Made in Italy" sesa "Made in Albania", qoftë ky dhe një shishe qumështi, që minimalisht është më i freskët e pse jo me të gjithë standardet kombëtare apo dhe ndërkombëtare të cilësisë.

Kur ndërmarrjet prodhuese të mesme dhe të vogla i hasin këto vështirësi në tregun e brendshëm, nuk ka nevojë për shumë fantazi të kuptohet sa e vështirë është dalja në tregjet ndërkombëtare, krijimi i emrit të mirë, konkurrimi mes markave të mirënjohura dhe të konsoliduara prej vitesh në treg, si dhe mungesa e politikave lehtësuese e favorizuese të taksimit. Aktualisht, pjesa me e madhe e ndërmarrjeve prodhuese, në vetvete janë vetëm ofruese shërbimesh fasonerie, pa pasur një markë të vetën "Made in Albania". Këto ndërmarrje kanë një veprimtari në dukje të madhe, por varen kryesisht nga një numër i vogël e shpesh vetëm nga një furnitor dhe klient, fakt ky që mbart një rrezik shumë të lartë për vazhdimësinë e biznesit në të tashmen e në të ardhmen, e çdo vështirësi e palës kontraktuese jep ndikim të drejtpërdrejtë e të menjëhershëm në likuiditetin e prodhuesit shqiptar.

Bujqësia dhe agrobiznesi po shihen si sektorë potencialë dhe vërtet të tillë janë, nëse nisemi nga natyra dhe gjeografia e vendit tonë. Në këtë sektor po vërehen përpjekje nga emigrantë shqiptarë, të kthyer me dëshirën për të investuar në Shqipëri kursimet e tyre, si dhe nga fermerë vendas, të cilët e shohin me optimizëm të ardhmen e këtij sektori, që po përmendet shpesh dhe në platformat apo axhendat qeveritare. Megjithëse premtues dhe me një treg të gjerë që pret të kreditohet nga bankat, ky sektor ka edhe një shkallë të madhe rreziku, sespe është shumë i lidhur me fatkeqësitë natyrore, po aq sa dhe me vështirësitë e sipërpermdura të garantimit të cilësisë dhe shitjes së produktit. Po kështu, në këtë sektor është edhe më e theksuar problematika e pronësisë së tokës dhe e vështirësisë së ofrimit të kolateralit, mungesa e të dhënave finaciare historike,



apo dhe e plan-bizneseve për të ardhmen. Projektet këshilluese, skemat e garancisë, në bashkëpunim me qeverinë apo dhe fonde të tjera garancie, do të ishin një ndihmesë shumë e madhe dhe një faktor që do të ndikonte ndjeshëm në rritjen e kreditimit të këtij sektori. Këto dy vitet e fundit po bëhen përherë e më tepër të pranishme firmat e konsulencës, të cilat bëjnë studime tregu dhe ofrojnë te NMV-të shërbime konsulence, por dhe plane biznesi profesionale, bazuar dhe në praktika ndërkombëtare.

Sektori i ndërtimit, ashtu siç i dha hov për një periudhë ekonomisë dhe kredithënies, po aq u kthye në një nga sektorët më të vështirë në mbledhjen e huave, duke mos u shoqëruar me të njëjtën fuqi blerëse për t'iu përgjigjur kësaj oferte për të blerë këto "produkte", të cilat tashmë kishin thithur jo pak likuiditete, duke bërë që një pjesë e tyre të mos kthehen në kohën e duhur, apo kurrë, në arkat e kredimarrësve, e më tej, as në sportelet e bankave, tek të cilat ato para ishin marrë hua. Ende sot ky sektor ndikohet nga mangësitë e formalizimit, hipotekimit dhe vështirësitë e përfitimt të një titulli pronësie, që do ta ndihmojë në huamarrje, e që për më tepër i shtohen dhe ulja e nivelit të dërgesave të emigrantëve, që deri dje ishin burimi kryesor i të ardhurave në tregun e pasurive të paluajtshme.

Ndër sektorët e tjerë të ekonomisë tashmë i kredituar nga bankat dhe që shfaq potencial, të paktën teorikisht dhe logjikisht, është ai i NMV-ve që

operojnë në Hoteleri – Turizëm. Pa i hyrë problematikave dhe vështirësive të lidhura me natyrën e shërbimit në këtë sektor, por bazuar më shumë në përlllogaritjet e rrepta të moduleve të analizave finaciare dhe koncepteve bazë të huadhënies, do të ishte guxim jo i vogël dhënia hua e parave të depozituesve, një biznesi që dje ishte dhe sot nuk është, apo sot është dhe nesër nuk i dihet...

Pavarësisht se ulja e normave të interesit nga Banka e Shqipërisë dhe e depozitave në bankat tregtare ka sjellë ulje të kostos së fondeve, që në kthim është shoqëruar me ulje të normave të interesit për huat, vlen të theksohet se NMV-të ende vuajnë nga pamjaftueshmëria, ose mungesa totale e kolateralit, shkalla jo e kënaqshme e formalizimit dhe mbajtjes së të dhënave finaciare, si dhe mospasja e nje plan-biznesi te mirëstrukturuar, i cili do të rriste besimin te bankat. Nga ana tjetër, duhet të jetë e qartë se bazat për një huadhënie të shëndoshë janë mbarëvajtja e biznesit, që ndikohet shumë nga faktorët ekonomike dhe politikë.

Politikat dhe platformat ekonomike, qofshin këto afatshkurtra apo afatgjata, duhen të jenë transparente dhe përtej qëllimit fisnik të zhdukjes së informalitetit dhe të venijes së kornizave "Made in UE", duhet të ofrojnë dhe një projektim të së ardhmes, ose të paktën të situatës drejt të cilës synohet të shkohet, si rezultat i veprimeve apo reformave fiskale apo dhe të çdo lloj natyre tjetër, por që ndikojnë si te konsumatori i vogël, aq dhe tek biznesi i NMV-ve.



nga Zj. Edlira LLANGO

Drejtoresh
AUTORITETI KOMBËTAR PËR
CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK (AKCE)

Gjeneza e nënshkrimit elektronik në Europë daton herët, në mesin e viteve '90, me Italinë dhe Gjermaninë, si vendet e para që kanë përmendur dhe përdorur nënshkrimin elektronik. Zyrtarisht në Komunitetin Europian do flitet për nënshkrimin elektronik në Direktivën Nr. 1999/93/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës, të datës 13 dhjetor 1999. Komunikimi dhe tregtia elektronike kanë nevojë për “nënshkrimet elektronike” dhe shërbimet e lidhura me to, për të mundësuar vërtetimin e të dhënave. Një kuadër i qartë i BE-së, lidhur me kushtet që zbatohen për nënshkrimet elektronike, do të rriste besimin dhe pranimin e teknologjive të reja në mënyrë që legjislacioni i shteteve anëtare të mos e pengonte lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve në tregun e brendshëm europian.

Nënshkrimi elektronik është një mjet verifikimi elektronik. Ky term përcaktohet

Nënshkrimi elektronik

Rëndësia dhe përparësitë e tij

● ● ●
Nënshkrimi elektronik është një teknologji që ka lindur si nevojë e garantimit të autenticitetit të një mesazhi elektronik të dërguar, pra siguron që autori i mesazhit elektronik është vërtet ai që pretendon të jetë, që identiteti i tij nuk është përdorur në mënyrë abuzive nga dikush tjetër dhe që mesazhi nuk është modifikuar gjatë transmetimit.

si verifikim i identitetit të zotëruesit dhe të dhënave të nënshkruara. Dokumenti elektronik, që përmban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me dokumentin shkresor.



Komunikimi elektronik me nënshkrim elektronik garanton siguri shumë të lartë. Çdo dokument elektronik është unik dhe nuk mund të kopjohet, sepse momenti i nënshkrimit të tij shoqërohet me një vulë kohore duke regjistruar saktësisht kohën e siglimit.

Në vendin tonë, për herë të parë termi “nënshkrim elektronik” është përmendur në ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, i hartuar në përputhje me Direktivën Europiane të sipërpërmendur. Në këtë ligj sanksionohet vlefshmëria ligjore e nënshkrimeve elektronike. Veprimet juridike dhe aktet e hartuara nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, mund të bëhen edhe

përmes një dokumenti elektronik, të cilit i bashkëlidhet një nënshkrim elektronik i kualifikuar. Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore. Nënshkrimin elektronik të kualifikuar mund ta ofrojnë ato subjekte që në ligj citohen si “Ofrues të Shërbimit të Certifikimit” (OSHC). Të tillë janë vetëm ata ofrues të cilët regjistrohen pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik, që është institucioni i ngarkuar ligjërisht për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Autoriteti ka për detyrë të mbikëqyrë me rigorozitet veprimtarinë e OSHC-ve, në mënyrë që ajo të kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe standardet europiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Lista e ofruesve të regjistruar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe atyre që kanë ndërprerë veprimtarinë, publikohet në faqen e internetit www.akce.gov.al.

Aktualisht, në vend ka dy OSHC, të regjistruar pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), e cila mundëson nënshkrim elektronik për të gjithë nëpunësit e ad-

ministratës shtetërore dhe Aleat sh.p.k, e regjistruar për të ofruar të njëjtin shërbim për qytetarët shqiptarë. Mediumi, apo pajisja në të cilën instalohet certifikata elektronike që mundëson nënshkrim elektronik, i zgjedhur në rastin e AKSHI-t, është një USB Token, ndërsa në rastin e Aleat sh.p.k, është letërnjoftimi biometrik, apo në gjuhën e përditshme karta e identitetit të shtetasve shqiptare. Kartat e identitetit, të lëshuara nga viti 2014 e në vijim, janë të pajisura edhe me certifikatat elektronike, që mundësojnë nënshkrim dhe identifikim elektronik pa kosto shtesë, ndërsa për qytetarët që kanë karta identiteti të lëshuara para vitit 2014, pajisja me certifikata elektronike mund të bëhet pranë zyrave të këtij ofruesi, të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe herën e parë është falas. Sigurisht, pajisja me këto certifikata elektronike nuk është e detyrueshme.

Rëndësia dhe përparësitë që ofron nënshkrimi elektronik

Pyetja që vjen natyrshëm në mendje, është: Pse duhet të përdorim nënshkrimin elektronik? Nënshkrimi elektronik është një teknologji që ka lindur si nevojë e garantimit të autenticitetit të një mesazhi elektronik të dërguar, pra siguron që autori i mesazhit elektronik është vërtet ai që pretendon të jetë, që identiteti i tij nuk është përdorur në mënyrë abuzive nga dikush tjetër dhe që mesazhi nuk është modifikuar gjatë transmetimit. Këto garanci janë thelbësore në përdorimin gjithnjë e në rritje të internetit, si një mjet i sigurt komunikimi midis qeverisë, qytetarëve dhe bizneseve.

Komunikimi elektronik me nënshkrim elektronik garanton siguri shumë të lartë. Çdo dokument elektronik është unik dhe nuk mund të kopjohet, sepse momenti i nënshkrimit të tij shoqërohet me një vulë kohore duke regjistruar saktësisht kohën e siglimit. Dokumentet elektronike, të nëshkruara me nënshkrim elektronik, nuk mund të modifikohen, pasi çdo modifikim do të ishte evident dhe do të zhvlerësonte legjitimitetin e dokumentit. Kjo, pasi nga ana informatike vetëm “gjurma e dokumentit”, e ashtuquajtura HASH, nënshkruhet. Vlera e HASH është e ndryshme për çdo dokument elektronik, edhe sikur ai të modifikohet sadopak, prandaj që nënshkrimi elektronik, nga pikëpamja



informatike, është i ndryshëm për çdo dokument. Verifikimi i vlefshmërisë së nënshkrimeve elektronike mund të kryhet nga çdo përdorues kompjuteri dhe sistemi i automatizuar, sipas kësaj teknologjie, nuk lejon vend për gabime. Ky instrument ofron jo vetëm siguri të lartë, por edhe përparësi të tjera, siç janë: lehtësia në përdorim, shpejtësia në komunikim, kosto e ulët, transparenca, shmangia e korrupsionit, për shkak të eliminimit të kontaktit fizik midis qytetarit dhe nëpunësit publik, si dhe mbrojtja e mjedisit, për shkak të eliminimit të letrës, bojës dhe printerit.

Të rejat në fushën e nënshkrimit elektronik

Në 23 korrik 2014, Parlamenti Europian dhe Këshilli miratuan Rregulloren nr.910/2014, “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në lidhje me transaksionet elektronike në tregun e brendshëm” (Rregullorja eIDAS). Kjo rregullore vendos një bazë të përbashkët për të gjitha vendet anëtare, duke i shtuar rregullimit të mëparshëm të nënshkrimit elektronik, sipas Direktivës 93/1999 edhe rregullimin për identifikimin elektronik, vulën elektronike, autentikimin e faqeve të internetit dhe shërbimin e transmetimit elektronik të të dhënave, duke siguruar të njëjtat rregulla e standarde të zbatueshme në të gjitha vendet e BE-së, në mënyrë që këto shërbime të jenë drejtpërdrejt të njohura ndërmjet vendeve anëtare. Nisur nga rëndësia që paraqesin këto shërbime, synohet që një rregullim i tillë të rrisë

besimin te përdoruesit, duke u shndërruar në shtyllën qendrore të ndërtimit të Tregut Elektronik të përbashkët europian. Rregullorja eIDAS është një gur themeli në sigurimin e një mjedisi rregullator, që mundëson ndërveprime elektronike të sigurta midis bizneseve, qytetarëve dhe autoriteteve publike. Në këtë drejtim, Rregullorja eIDAS:

- siguron që qytetarët dhe bizneset mund të përdorin skemat e tyre kombëtare elektronike të identifikimit për lehtësi hyrje në shërbimet publike në vendet e tjera të BE-së;

- krijon një treg të brendshëm europian për shërbimet e besuara, duke siguruar se ata që do të punojnë përtej kufijve do të kenë të njëjtin status ligjor si në proceset tradicionale të bazuara në letër.

Vetëm duke ofruar siguri për vlefshmërinë ligjore të të gjitha këtyre shërbimeve, bizneset dhe qytetarët do të përdorin ndërveprimet numerike, si rruga e tyre e natyrshme e ndërveprimit.

Duke u mbështetur në këtë rregullore, sidomos duke e konsideruar nevojë të tregut tonë, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik udhëhoqi punën për hartimin e projektligjit: “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i cili pritet të miratohet së shpejti nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky projektligj mbush boshllëkun ligjor, për sa i përket shërbimeve të nevojshme për komunikimin online, të sigurt dhe ligjërish të mbrojtur mes qytetarëve, bizneseve dhe qeverisë, duke i hapur rrugë komunikimit të sigurt online.

Kredi Personale

**Shihemi
në Janar**



**Mermi një kredi tani dhe
filloni ta paguani në Janar 2016**

www.raiffeisen.al



**Raiffeisen
BANK**

Oferta e vlefshme nga 1 Shtator – 24 Tetor 2015.



nga Z. Ardian HASA

Drejtor i Divizionit Operacional
SOCIETE GENERALE ALBANIA

Në ditët e sotme nuk përbën më risi fakti që bankat janë gjithnjë e më shumë në kërkim të përsosmërisë dhe sigurisë në të gjitha proceset e bankës. Po ashtu, edhe klientët nga ana e tyre kërkojnë gjithnjë e më shumë shërbime cilësore dhe të sigurta. Në vitet e fundit të gjitha bankat kanë rritur në mënyrë të ndjeshme numrin e veprimeve që kryhet pa prezencën fizike të individit në degët e bankës, por edhe në rastet e prezencës fizike në degë, identifikimi dixhital i klientit dhe nënshkrimi elektronik janë kritere sigurie shumë të rëndësishme.

Miratimi i ligjit për nënshkrimin elektronik krijon hapësirën e nevojshme ligjore që institucionet të investojnë në drejtim të autentikimit dhe nënshkrimit elektronik, si mjeti më i sigurt që siguron si identitetin e qytetarit, ashtu edhe nënshkrimin me të njëjtën vlerë ligjore të dokumenteve elektronike. Gjithsesi, miratimi i këtij ligji duhet të shoqërohet edhe me përditësimin e të gjithë kuadrit

Mundësi të reja për lehtësimin e shërbimeve online

Integrimi i autentikimit dhe nënshkrimit elektronik me sistemet "online banking" do të bënte të mundur që klienti të kryente në distancë të gjithë procesin, që nga regjistrimi në bankë dhe pajisja me një llogari, deri te hapja e depozitave dhe marrja e huave.

ligjor, i cili shërben si rregullator për shërbimet bankare dhe marrëdhëniet ndërmjet qytetarit dhe institucioneve, në mënyrë që ky realitet i ri të kthehet në diçka të prekshme me përfitime reale për të gjithë aktorët.

Sikurse u prezantua edhe në Javën e Inovacionit, një veprimtari e organizuar nga Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, në maj 2015, Banka Societe Generale Albania është një ndër institucionet që ka parë mundësinë e integritit të këtyre shërbimeve me shërbimet e tjera bankare, për të ofruar një eksperiencë të re për klientët e saj.

Duke përdorur një platformë të sigurt, të ofruar nga shoqëria e njohur ALEAT dhe garantuar nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, banka synon të ofrojë shërbime të reja për klientët e saj si: autentikimi dixhital (përdorimi i certifikatës që ndodhet e instaluar në kartën e identitetit të qytetarit dhe konfirmimin nëpërmjet gjurmës biometrike të gishtërinjve dhe nënshkrimi elektronik (përsëri nëpërmjet përdorimit të certifikatës së instaluar në kartën e identitetit)). Thënë me thjeshtë, me paraqitjen e klientit në degë atij do t'i kërkohet nga punonjësi i bankës të paraqesë kartën e tij të identitetit dhe pasi vendoset ajo në lexuesin biometrik

të kartës bëhet konfirmimi nëpërmjet gjurmës së gishtit të klientit, e në këtë mënyrë, sigurohet autentikimi i tij dhe i hapet rruga kryerjes së veprimit të kërkuar nga klienti. Gjithashtu, edhe për nënshkrimin elektronik procesi është i ngjashëm. Pas gjenerimit në versionin elektronik të dokumentit, që duhet nënshkruar nga klienti, ai nënshkruhet në fillim nga punonjësi i bankës në mënyrë elektronike dhe më pas nga klienti po në mënyrë elektronike, nëpërmjet certifikatës së instaluar në kartën e tij dhe konfirmimit me gjurmën biometrike. Më pas ky dokument ruhet nga banka dhe ka të njëjtën vlerë ligjore me dokumentet e nënshkruar në letër.

Kjo është vetëm njëra anë e medaljes, pasi një shërbim i tillë do të krijonte shumë mundësi të reja për shtimin e shërbimeve online, të ofruara nga banka. Integrimi i autentikimit dhe nënshkrimit elektronik me sistemet online banking do të bënte të mundur që klienti të kryente në distancë të gjithë procesin, që nga regjistrimi në bankë dhe pajisja me një llogari, deri te hapja e depozitave dhe marrja e huave, duke sjellë kështu një realitet të ri për sa i përket përsosmërisë në përdorimin e burimeve të bankës dhe sigurisë në proceset dhe shërbimet bankare.



nga **Z. Alexander ZSOLNAI**

Zëvendës Kryetar i Bordit Drejtues
RAIFFEISEN BANK – ALBANIA

Fshirja e huave nga bilanci është sot fjala e ditës për sistemin bankar shqiptar. Për shkak të rregullores së re të Bankës së Shqipërisë, që e bën fshirjen e ekspozimit ndaj një huaje të detyrueshme pas përmbushjes së kriterëve të përcaktuara prej saj, kjo temë bëhet tashmë më shumë se "kryefjalë". Këtu është e rëndësishme të theksohet se kjo është vetëm një temë e vogël, në kuadrin e çështjes madhore të nivelit të lartë të huave me probleme në sistemin bankar shqiptar. Gjithashtu, mbetet e rëndësishme të pohohet qartë se fshirja e huave nuk është/përbën çelësin për zgjidhjen e këtij problemi. Konkretisht, kjo përbën një detyrë e vogël "teknike", lidhur me parimet e kontabilitetit.

Fshirja e huave përkufizohet si nxjerrja, apo heqja, e i një borxhi të keq ose të pambledhshëm nga pasqyrat financiare të bankës. Fshirja e huave paraqitet si një proces i vazhdueshëm dhe dinamik, ku banka vlerëson cilësinë e portofolit të aktiveve të saj. Kur mbi bazën e të dhënave dhe ngjarjeve aktuale,

Fshirja e huave në sistemin bankar shqiptar Çfarë vjen më pas?



Fshirja e huave përmirëson mjaftueshmërinë e kapitalit dhe nuk jep ndikim negativ të papritur mbi fitimin, duke i dhënë bankës më shumë hapësirë për huadhënie. Ajo është pjesë normale e veprimtarisë bankare, gjatë ciklit të jetës së një huaje, por duhet të jetë e qartë se fshirja e huave është thjesht një veprim kontabël.



huaja konsiderohet si e pamundur për t'u mbledhur, menaxhimi i bankës mund të marrë vendimin për ta fshirë aktivin. Ky proces rregullohet nga Banka Qendrore, SNRF-të dhe procedurat e brendshme të çdo banke. Gjithashtu, edhe rregullat e legjislacionit tatimor duhet të zbatohen



Duke lënë mënjanë mjedisin aktual dhe pritshmëritë për ardhmen, historiku i zhvillimit të huave të pambledhura (fshirjeve të huave), është një tregues kyç që kushtëzon strategjinë e re të huadhënies dhe oreksin për rrezik të një banke. Sa për huadhënien e re, këtu një rëndësi të madhe paraqet besimi sipërmarrës i konsumatorëve dhe nismat e tyre për investime të reja vendase dhe të huaja (apo konsumi për klientët privatë).



me këtë rast. Rregullorja e Bankës së Shqipërisë: "Për Administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët

e bankave të huaja" përcakton qartë procesin e vendim-marrjes, autoritetet miratuese dhe rregullat që zbatohen në raste të tilla. Natyrisht, përkeqësimi i kushteve ekonomike rrit numrin e huave me probleme ose të pambledhshme, e rrjedhimisht, edhe vëllimin e huave të fshira, por procesi në vetvete nuk ka asnjë ndryshim. Ajo duhet kryhet në të njëjtën mënyrë, pavarësisht nga situata në të cilën gjendet industria bankare. Megjithatë, fshirja e huave nuk nënkupton që banka heq dorë nga e drejta e pretendimit të saj mbi borxhin që ka huamarrësi. Industria bankare është dëshmitare e disa sinjaleve alarmuese, kur klientët, por dhe vet gjykatat, e keqinterpretajnë procesin e fshirjes së huave, duke menduar se borxhi në këtë rast shuhet! Ky lloj fenomeni duhet të monitorohet nga afër dhe të parandalohet!

Sigurisht, procesi i fshirjes së huave përmirëson raportin dhe nivelin e huave me probleme të bankës, lidhur me cilësinë e aktiveve. Një bilanc i "pastër" krijon një ide më të mirë rreth pasurisë reale të bankës dhe të potencialit të saj për të prodhuar fitim dhe absorbuar rreziqet. Gjithashtu, raporti i huave me probleme të tregut bankar, në vijim, do të jetë më i saktë. Pra, për sa i përket bilanceve, ky proces jep një efekt pozitiv. Nëse flasim për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe përfitueshmërisë së

bankave, efekti mund të jetë i dyanshëm. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit lidhet me kujdesin që tregon banka në mbulimin e aktiveve në rrezik. Nëse e shohim të lidhur me procesin e fshirjes së huave, atëherë evidentohet një lidhje të drejtpërdrejt me politikat dhe metodologjitë e provizionimit, që ndjekin bankat. Fshirja e një huaje paraprihet gjithmonë nga një vlerësim i vazhdueshëm i mundësisë së bankës për të rimarrë mbapsht huan me probleme. Sipas rregullave të Bankës Qendrore (BSH), si dhe rregullave të SNRF-ve (IFRS), banka vlerëson vazhdimisht humbjet e mundshme që shkaktohen nga një hua e caktuar me probleme, duke provizionuar humbjet që lidhen me të. Këto provizione kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi fitimin dhe humbjen, kështu që banka mund të ngurrojë të caktojë një nivel të përshtatshëm të provizioneve, por që më vonë kjo mund të çojë në reduktim të drejtpërdrejt të vlerës së aktivitetit (write-down). Reduktimi i drejtpërdrejt i vlerës është në vetvete fshirje e një huaje, e cila nuk është e mbuluar siç duhet me provizione dhe përfaqëson një humbje të papritur në pasqyrën e fitim-humbjeve të bankës.

Lidhur me pjesën e pasiguar të portofolit, huat që kërkohen të fshihen duhet të jenë plotësisht të mbuluara me provizione, kështu nuk ka nevojë që banka të kryejë reduktime të drejtpërdrejta të vlerës së tyre. Në kushte të tilla, fshirja e huave përmirëson raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, pasi në momentin e fshirjes, kjo e fundit jep ndikim vetëm mbi aktivet e peshuara me rrezik. Lidhur me portofolin e siguruar, në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), bankat duhet të përllogarisin reduktime të vlerës së aktiveve, në shumën e vlerës së peshuar të kolateralit të planifikuar për mbulimin e ekspozimit të klientit gjatë fshirjes së huas. Ky veprim ka ndikim të drejtpërdrejt negativ në fitimin e raportuar të bankës, e në të njëjtën kohë, në mjaftueshmërinë e kapitalit.

Rregullorja e Bankës së Shqipërisë u kërkon bankave që të fshijnë huat "... jo më vonë se 3 vjet pas klasifikimit e tyre si "kredi të humbura" dhe klasifikimi përgjithësisht bazohet në ditë-vonesat, ose "...kur ose banka ka depozituar te



Fshirja e huave nuk nënkupton që banka heq dorë nga e drejta e pretendimit të saj mbi borxhin që ka huamarrësi. Industria bankare është dëshmitare e disa sinjaleve alarmuese, kur klientët, por dhe vet gjykatat, e keqinterpretojnë procesin e fshirjes së huave, duke menduar se borxhi në këtë rast shuhet! Ky lloj fenomeni duhet të monitorohet nga afër dhe të parandalohet!



përmbartuesi gjyqësor kërkesën për fillimin e procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateralit, në rast se kredia është e siguruar me kolateral". Në metodologjinë e provizionimit, SNRF-të marrin parasysh vlerën e peshuar të kolateralit, që është krejt ndryshe nga rregullat dhe standardet kombëtare (BSH), që nuk e merr parasysh atë. Kështu, në bazë të SNRF-ve, një hua duhet fshirë pasi janë ezauruar të gjitha përpjekjet për ekzekutimin e kolateralit. Në rast të një procesi ekzekutimi jo të suksesshëm, banka, me qëllim që të jetë në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë, mund të jetë e detyruar të fshijë huan, përpara ekzekutimit të kolateralit. Gjithsesi, fshirja e huas përpara përfundimit të procedurës përmbartimore, shkakton një reduktim të

drejtpërdrejt të aktivitetit, duke shkakuar kështu humbje, në bilancin sipas SNRF-ve.

Duke marrë në konsideratë arsyen e mësipërme, është kritike që bankat të sigurojnë:

- Një vlerësim të përshtatshëm të humbjeve të mundshme nga zhvlerësimi, duke krijuar një fond të mjaftueshëm provizionimi (rezervë);
- Kryerjen e një procesi efektiv ekzekutimi, brenda një periudhe kohe të arsyeshme dhe në kuadër të një sistemi juridik të besueshëm. Një rishikim i përgjithshëm i legjislacionit, me qëllim kryerjen e përmirësimeve pozitive, përfshirë këtu dhe procedurat e zyrave hipotekare, do të ishte një mbështetje për bankat, në drejtim të optimizimit të procesit të fshirjes së huave.

Në të njëjtën kohë, ekziston dhe kufizimi i udhëzimit për tatimin mbi të ardhurat, që thotë "...borxhi i keq mund të fshihet nga librat kontabël: i) 365 ditë pas depozitimit të kërkesës për fillimin e procedimit të ekzekutimit të detyrueshëm të përmbartuesi gjyqësor, në rast se kredia është e siguruar me pasuri të luajtshme ose të paluajtshme; ose ii) 365 ditë pas lëshimit nga gjykata të urdhrimit të ekzekutimit, në rast se kredia nuk është e garantuar me pasuri të luajtshme të paluajtshme." Në rrethana të tilla, banka është e "detyruar" të rrisë kostot e saj për të mbuluar shpenzimet ligjore dhe të ekzekutimit, edhe për rastet kur banka nuk pret rimarrje/rikuperim, nëpërmjet procedurave li-

ONLINE BANKING



KURSIM KOHE NË SIGURI TË PLOTË

SE BASHKU FORCOJME SHPIRTIN E SKUADRES



**SOCIETE GENERALE
ALBANIA**

gjore / të ekzekutimit. Kjo është e vëmtejta mënyrë për të shmangur tatimin shtesë mbi huat me probleme, apo të pambledhshme. Ky mund të jetë rasti për të mos harmonizuar legjislacionin tatimor me procedurat ligjore, ose të ekzekutimit.

Siç shihet, bankat duhet të zbatojnë disa rregullore dhe akte, të cilat nuk janë gjithmonë të harmonizuara me njëra-tjetrën. Prandaj, autoritetet shqiptare duhet të ndërmarrin hapa për harmonizimin e tyre, përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të procesit të provizionimit dhe fshirjes së huave (p.sh.: zbatimin e SNRF-ve në rregulloret Bankës së Shqipërisë, lidhur me provizionimet, harmonizimin me legjislacionin tatimor, etj.)

Por a mund të jetë i dobishëm për bankat procesi i fshirjes së huave? Siç u përmend më lart, procesi i fshirjes së huave paraprihet nga një vlerësim periodik i aftësisë së bankës për të rimarrë një hua me probleme, duke e provizionuar mjaftueshëm atë. Provizionet kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi fitimin. Përveç kësaj, para se të kalohet në fshirjen e huave, banka duhet të

përballojë kosto të konsiderueshme, lidhur me ekzekutimin e huave me probleme. Nuk mund të pohohet se procesi i fshirjes së huave është thjesht në vetvete i dobishëm; ajo është pjesë normale e veprimtarisë bankare, gjatë ciklit të jetës së një huaje. Nga ana tjetër, duhet të jetë e qartë se fshirja e huave është thjesht një veprim kontabël! Edhe pas fshirjes së huas, detyrimi i klientit për të shlyer borxhin e tij vijon të ekzistojë. Kështu, banka mund të vazhdojë veprimtarinë e saj e rikuperimit/rimarrjes së huas, të ekzekutimit të kolateralit, ose të shesë borxhin të tretët. Sigurisht, ajo që ka më shumë rëndësi dhe që kërkohet nga bankat është një proces i kujdesshëm i menaxhimit të rrezikut.

Tani le t'i rikthehemi ndikimit që mund të kenë fshirjet masive të huave në sistemin bankar mbi një ringjallje të mundshme të huadhënies dhe për një lehtësim të rreziqeve të perceptuara nga bankat. Ta themi hapur, fshirja e huave nuk ka veçse një ndikim minimal. Arsyet për këtë u thanë më sipër. Sigurisht, kur fshirja e huave bëhet përkundrejt provizioneve, përmirëson mjaftueshmërinë e kapitalit dhe nuk jep

ndikim negativ të papritur mbi fitimin, duke i dhënë bankës më shumë hapësirë për huadhënie. Por me kaq mbaron, pasi zgjerimi i veprimtarisë bankare dhe huadhënies së re përgjithësisht përfshin dhe shumë faktorë të tjerë, si: stabiliteti ekonomik dhe politik, niveli i korrupsionit dhe informalitetit, legjislacioni i kujdesshëm, sistemi efektiv gjyqësor dhe mundësia për të vijuar një procedurë efikase ekzekutimi, pa përjetuar dëme ose vonesa përmes proceseve gjyqësore, ose procedurave të zyrove hipotekare. Sigurisht, duke lënë mënjanë mjedisin aktual dhe pritshmëritë për ardhmen, historiku i zhvillimit të huave të pambledhura (fshirjeve të huave), është një tregues kyç që kushtëzon strategjinë e re të huadhënies dhe oreksin për rrezik të një banke. Sa për huadhënien e re, këtu një rëndësi të madhe paraqet besimi sipërmarrës i konsumatorëve dhe nismat e tyre për investime të reja vendase dhe të huaja (apo konsumi për klientët privatë). Këto plane duhet t'u paraqiten bankave në një mënyrë shumë më profesionale dhe të strukturuar, sesa ato që janë bërë në të kaluarën.





nga Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Zhvillimet dhe evolucioni i muajve të fundit në ekonominë greke në përgjithësi dhe situata e saj mjaft komplekse financiare dhe bankare e rikthyen krizën greke në qendër të vëmendjes ndërkombëtare, veçanërisht anëtarëve të Trojkës: Komisioni Europian, FMN dhe BQE. Fitorja e SYRIZA-s dhe Kryeministrit Cipras u shoqërua me një retorikë politike, në themel të së cilës qëndronte “*ndalimi i masave shtrënguese që po ndikonin negativisht në ekonominë, financat dhe nivelin e jetesës së popullit grek*”, “*kushtet shtrënguese dhe negociatat për rigorozitetin buxhetor e financiar apo trajtimin e borxhit grek dubeshin rishikuar*”, “*me partnerët evropianë, BQE dhe FMN duhej negociuar mbi baza të reja më lehtësuese e në terma më afatgjata*”, etj. Ndërkohë, treguesit kryesorë ekonomikë e financiarë të Greqisë, përfshirë këtu dhe situatën e sektorit të saj bankar, vazhdonin të përkeqësoheshin

Bankat greke përballë krizës Efektet dhe masat në Ballkan dhe Shqipëri

Që prej vitit 2010 janë bërë ndryshime ligjore, duke i konsideruar bankat greke si filiale e duke i ngarkuar përgjegjësitë e tyre të shkëputura nga bankat mëmë në Greqi. Banka e Shqipërisë ka marrë masa që, nga pikëpamja ligjore dhe organizimi i tyre, ato të kenë një pavarësi nga bankat mëmë greke.

me shpejtësi. Borxhi sovran grek arriti shifrën e frikshme me rreth 310 miliardë euro ose afërsisht 180% të PBB-së, ekonomia u tkurr me 25% në 4-5 vitet e fundit, papunësia u rrit ndjeshëm, sidomos te të rinjtë, duke ju afruar shifrës 50%, etj.

Tensionet e krijuara ndërmjet qeverisë së re në Athinë, me frymë të qartë “*antieuropiane*”, “*antikapitaliste*” e “*antiglobaliste*”, të personifikuar në profilin dhe deklaratat jo pak ekscentrike të ministrit të financave z. Varoufakis, me Trojkën dhe kreditorët u pasqyruan në një situatë sa kaotike aq dhe të tensionuar në periudhën maj-gusht 2015. Këmbëngulja e Greqisë për “*ndryshimin e rregullave të lojës*”, përfshirë këtu dhe trysninë me referendumin, që i dha legjitimitet qeverisë për t’i thënë “*JO*” kushteve “*poshtëruese*” të Trojkës dhe BE-së, u ndesh me rezistencën e vendosur të Eurogrup-it, FMN-së e BQE-së. Përkeqësimi i situatës u pasqyrua më së miri në skenarët e cilësuar si “*katastrofikë*” të daljes së Greqisë nga zona Euro e deri te përjashtimi nga BE-ja, nga shpallja e falimentimit të shtetit grek, etj. I trondituri i madh i kësaj situatë ishte dhe sistemi bankar grek, i cili në fund të muajit qershor 2015 u detyrua të vendoste sistemin e kontrollit

të kapitaleve, duke kufizuar tërheqjen ditore në 60 euro. Agjencia Fitch deklaronte se kontrolli i kapitaleve ishte hapi i fundit i domosdoshëm që disa banka të rëndësishme greke të mos shpallnin falimentimin, aq më tepër që Greqia nuk kishte asnjë mundësi që të realizonte një rikapitalizim të mundshëm të bankave të saj. Vështirësi e pengesa



Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe mjaft ekspertë të financave dhe sistemit bankar konfirmuan se Shqipëria nuk cënohet nga situata që po përjeton qeveria dhe bankat greke.



me natyrë strukturore qëndronin dhe përballë mundësisë që të vihej në veprim Mekanizmi Europian i Stabilitetit (MES).

Çdo ditë e më tepër, sidomos gjatë muajit korrik 2015, në deklaratat e Shoqatës së Bankave Greke dhe drejtuesve të lartë të Bankës Kombëtare të Greqisë mbizotëronte frika se “*likuiditetet ishin të kufizuara dhe gjithshka*



do të varej nga reagimi dhe vendimet e BQE". Nevojat për çeljen e një linje likuiditetesh urgjente, në shumat 80-90 miliardë euro, nga BQE ishte oksigjeni i vetëm për të mos lejuar shembjen e sistemit. Ndërkohë, një sasi kolosale prej dhjetra miliarda eurosh kishte dalë e vazhdonte të dilte jashtë sistemit bankar grek, në formën e transfertave apo tërheqjes së depozitave. Sipas Kryetarit të Shoqatës së Bankave Greke, *"mbulimi me likuiditete në këto momente në bankat greke nuk ishte më shumë se 1 miliard euro; ose 90 euro për banor"*. Marrëveshja *"tejet e vështirë dhe mjaft e tensionuar"* e arritur me kreditorët, Eurogrup-in dhe Trojkën në muajin gusht 2015, megjithëse nuk ishte aspak ajo e shpresuar nga qeveria greke, i dha gjithsesi një zgjidhje daljes nga situata emergjente dhe e rifuti në rrugën normale trajtimin e borxhit grek dhe qetësimin e stabilizimin e sistemit bankar.

E gjithë kjo situatë u pasqyrua dhe në një shqetësim me përmasa rajonale në vendet e Europës Juglindore ku prezenca bankare dhe financiare greke ishte e


konsiderueshme. A rrezikoheshin vende si: Shqipëria, Bullgaria, Rumania, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Kosova, Bosnjë-Hercegovina, etj., që të përfshiheshin në vorbullën e krizës së sistemit bankar grek? Bankat greke të nivelit të dytë rezultojnë të kenë rreth 2.500 filiale në vendet e Ballkanit dhe më shumë se 40 mijë të punësuar. Kjo pyetje shtrohet për faktin se, nëse Athina nuk arrinte të shlyente borxhet e saj ndaj kreditorëve ndërkombëtarë, huadhënësit grekë që kontrollonin sektorë të rëndësishëm bankarë në këto vende mund të provokonin një tërheqje masive të kapitaleve të tyre. Nga ana tjetër, miliona persona që i kishin depozitat e tyre në bankat lokale me pronësi apo kapital grek mund të prekeshin, nëse do të kishte krizë totale bankare në Greqi. Bankat greke zotërojnë banka të rëndësishme në këto shtete të Europës Juglindore dhe shqetësimi ishte se, në rast se Athina do të detyrohej të dilte nga Eurozona, huadhënësit e saj mund të falimentonin, me një efekt domino në degët e tyre. Standard and Poor's paralajmëroi se

mund të zhvlerësojë klasifikimin e besueshmërisë të Bullgarisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Rumanisë dhe Serbisë, në rast se telashet e Greqisë do të përhapen në sistemin e tyre bankar.

Në rast se qeverive të ndryshme do t'u duhej të ndërhynin për t'i shpëtuar ato, kjo do të dëmtonte financat kombëtare dhe perspektivën afatgjatë të rritjes, do të dobësonte parametrat fiskalë dhe të borxhit të qeverive përkatëse. Sipas "Standard and Poor's", kjo mund të ndikonte negativisht në vlerësimin dhe renditjen e tyre". Prania e bankave greke, ose me kapital origjine grek, është e konsiderueshme në rajon. Konkretisht, duke ju referuar të dhënave të tremujorit të parë të vitit 2015, tre bankat greke në Shqipëri zotërojnë rreth 32% të kapitalit bankar, në Maqedoni dy banka greke zotërojnë 20% të kapitalit bankar, në Serbi katër banka greke zotërojnë 15% të këtij kapitali, në Rumani katër banka greke zotërojnë 17.6% të kapitalit bankar.

Megjithatë, si efekt i një sërë politikash e masash të reja antikrizë, apo

KLIENT
PAGAMARRËS
PAKETA E PAGËS



Ogriby & Mather Albania

**Merrni në dorë drejtimin
e të ardhurave tuaja!**

www.tiranabank.al

PIRAEUS BANK GROUP

 **TIRANA
BANK**
tani mundesh

kujdes prudencial të viteve të kaluara, kjo frikë dhe kjo situatë negative nuk u vërtetua. Masat kryesore parandaluese konsistojnë në:

- **Bullgari**, bankat me pronësi greke nuk mbanin letra me vlerë të Thezarit Grek dhe nuk i kishin të lidhura politikat e tyre financiare me bankat mëmë në Greqi, ndërkohë që edhe banka qëndrore e Bullgarisë kërkonte fuqizimin e likuiditetit në bankat me kapital grek si dhe kishte vendosur kontroll dhe përcaktuar kufizime për transferimin e kapitaleve financiare në drejtim të Greqisë;

- **Rumani**, degët apo filialet e bankave greke u mbajtën vazhdimisht nën vëzhgim, duke iu kërkuar të kishin një nivel mjaftueshmërie kapitali prej 17%, edhe pse niveli minimal i kërkuar në Rumani për bankat e tjera ishte vetëm 10%. Gjithashtu, këto banka kishin bërë një marrëveshje me qeverinë, për sigurimin e letrave me vlerë në mënyrë që të garantonin stabilitetin financiar;

- **Maqedoni**, ku ka dy banka në pronësi greke, bankat mëmë në Greqi u ndaluan të tërheqin kapitalin e tyre mbi pragun 10%, ose të shesin aksionet e tyre në një investues të ri. Nga ana tjetër, qeveria maqedonase përgatiti një fond prej 250 milionë euro, si garanci rezervë për kapitalizimin e bankave, nëse do të vërtetohej skenari i rrezikut të falimentimit nga tërheqjet masive dhe paniku;

- **Serbi**, ku veprojnë katër banka me kapital grek, që llogaritet se zotërojnë rreth 4 miliardë dollarë aktive, u morën masa energjike për monitorimin e përhershëm të planit të biznesit të këtyre bankave, veçanërisht nivelin e likuiditetit të tyre dhe marrëdhëniet me bankat mëmë në Greqi.

- Ndërkaq, sa i përket **Kosovës**, ndikimi i drejtpërdrejtë i krizës në Greqi vlerësohet të jetë minimal, pasi ekonomia e Kosovës ka një shkallë shumë të ulët të ekspozimit të drejtpërdrejtë ndaj sistemit bankar dhe ekonomisë greke.

Po Shqipëria si paraqitet në një kontekst dhe situatë të tillë? Banka e parë private në Shqipëri u hap në vitin 1996 dhe ajo ishte një bankë greke, e cila më pas u bë një gjigant i rëndësishëm rajonal. Bankat e tjera greke erdhën në fund të viteve '90, për të përfituar nga

fakti që Shqipëria ndodhej në momentet e ndërtimit dhe ngritjes së sistemit të saj bankar privat, si dhe për të mbështetur një lloj zgjerimi rajonal të Greqisë në vendet e Ballkanit. Në vitin 2008, bankat me kapital grek kishin 28% të aktiveve të sistemit bankar, por pesha e tyre në ekonominë shqiptare erdhi duke u tkurrur gjatë viteve 2008 - 2011. Deri në fund të shtatorit 2011, katër bankat me origjinë kapitali nga Greqia zinin 22% të totalit të aktiveve të sistemit, ndërkohë që në vitin 2010, zinin 23.1%. Rënia më e madhe vërehet në tregun e huas, ndërkohë që për depozitat këto banka mbeten përgjithësisht njësoj të



Rënia e peshës së këtyre bankave në tregun e huas përbën në fakt një lajm negativ për ekonominë shqiptare, pasi veprimtaria e tyre, gjatë periudhës 2002-2008, e ndihmoi rritjen ekonomike të vendit. Aktualisht, bankat me kapital grek zotërojnë 17% të totalit të aktiveve, 16% të depozitave, ose 1.2 miliardë euro dhe 17% të stokut të huas.



parapëlqyera nga shqiptarët. Këto banka zotëronin 29 % të tregut të huas në vitin 2011 nga 34.5% që zotëronin në vitin 2010 dhe 41% që zotëronin në vitin 2008. Rënia e peshës së këtyre bankave në tregun e huas përbën në fakt një lajm negativ për ekonominë shqiptare, pasi veprimtaria e tyre, gjatë periudhës 2002-2008, e ndihmoi rritjen ekonomike të vendit. Aktualisht, bankat me kapital grek zotërojnë 17% të totalit të aktiveve, 16% të depozitave, ose 1.2 miliardë euro dhe 17% të stokut të huas. Raporti hua-depozita në këto banka është rreth 62%.

Kriza greke në përgjithësi, por veçanërisht prejka që pati sistemi bankar grek prej saj, evidentoi mjaft shqetësimet edhe në Shqipëri. A do çenohet Shqipëria dhe stabiliteti financiar i saj në rastin e një skenari negativ në bankat me kapital grek? A rrezikohen këto banka nga falimentimi? A ka shanse që një

pjesë e rëndësishme e kapitalit të këtyre bankave të transferohet në Athinë, për të zgjidhur problemet e bankave mëmë? A rrezikohen 1.2 miliardë euro depozita të shqiptarëve që ndodhen në këto banka në Shqipëri? Garancia se asnjë prej këtyre skenarëve nuk pritej të ndodhte, e në fakt nuk ndodhi, erdhi nga vet Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe mjaft ekspertët të financave dhe sistemit bankar konfirmuan se Shqipëria nuk çenohet nga situata që po përjeton qeveria dhe bankat greke. Bankat shqiptare me kapital grek nuk janë degë të bankave greke, por filiale dhe si të tilla, ato kanë pavarësi të plotë. Që prej vitit 2010 janë bërë ndryshime ligjore, duke i konsideruar ato si filiale e duke i ngarkuar përgjegjësitë e tyre të shkëputura nga bankat mëmë në Greqi. Banka e Shqipërisë ka marrë masa që, nga pikëpamja ligjore dhe organizimi i tyre, ato të kenë një pavarësi nga bankat mëmë greke. Bankat shqiptare me kapital grek në Shqipëri janë me tepriçë likuiditeti dhe me tepriçë kapitali, pra, janë të mirëkapitalizuara. Mjaftueshmëria e kapitalit për bankat greke është mbi mesataren, konkretisht rreth 17%, kundrejt 12% që vendoset si kërkesë rregullatore për bankat në Shqipëri. Gjithashtu, bankat me kapital grek e kryejnë veprimtarinë e tyre thuhet me 100% depozita të shqiptarëve. Duhet theksuar se, një situatë mosbesimi nga ana e depozituesve është e pranishme, por janë marrë masa që ato të jenë me tepriçë likuiditeti dhe nuk parashikohet asnjë problematikë. *“Sistemi bankar shqiptar, përfshirë edhe bankat me kapital grek, është financiarisht dhe operacionalisht i pavarur nga sistemet bankare në vende të tjera. Të gjitha bankat tregtare operojnë në Shqipëri si njësi të pavarua ligjore, nën kuadrin legjislativ e rregullator shqiptar, përfshirë kërkesat për kapital dhe mbikëqyrjen bankare”...* *“Sikundër reflektohet në pasqyrat financiare dhe informacionet e publikuara rregullisht, sistemi bankar në Shqipëri ka nivele të larta mjaftueshmërie kapitali dhe likuiditeti, çka garanton stabilitetin e tij, funksionimin normal, dhe mos-ndikimin nga zhvillimet negative në vendet fqinjë”,* pohoi pa asnjë ekuivok Shoqata Shqiptare e Bankave.

Përgjegjshmëria Sociale



Festivali i Birrës në Korçë

Banka sponsorizoi Festivalin e Birrës, i cili organizohet me sukses prej 8 vitesh, në qytetin e Korçës. Festivali ka si objektivi të ardhshëm të publikun, nëpërmjet koncerteve dhe spektakleve, duke i dhënë një theks të veçantë argetimit të fëmijëve. Nëpërmjet këtij organizimi dhe falë zhvillimit turistik dhe ekonomik që ky projekt ka sjellë në qytet, Korça ka fituar çmimin për turizmin në vitin 2010.



Sipërmarrësit e rinj të Shqipërisë - Sponsorizim

Së bashku me Dhomën e Tregtisë dhe shoqërinë Çelësi, banka bëri të mundur realizimin e projektit "Sipërmarrësit e rinj të Shqipërisë", e nisur nga Partnerët Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Manaxhim Konflikti. Projekti kishte si objektivi mbështetjen ndaj studentëve të shkollave profesionale, duke hartuar dhe shitur idetë e tyre të biznesit dhe erdhi si një kërkesë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në përputhje me prioritetet strategjike të Strategjisë Kombëtare për punësim dhe aftësim, 2014 - 2020. Banka sponsorizoi projektin "Shkopi Smart", një shkop i dizajnuar për të dhënë ndihmë për njerëzit e verbër.



Banka dhuron një pajisje me rreze X për foshnjat

Në bashkëpunim me Fondacionin "Nëna dhe Fëmija", banka dhuroi pranë Maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", një pajisje me rreze X, e cila do të ndihmojë personelin mjekësor që të evidentojë në kohë probleme të ndryshme potenciale për fëmijët e porsalindur.

Nisma "Adopto një çerdhe"

Alpha Bank Albania u angazhua në rehabilitimin e strukturës së brendshme të çerdes "Zërat e jetës", në zonën e Kamzës. Krahas

rinovimit të kushteve të dhomave të qëndrimit të fëmijëve, Banka gjithashtu përmirësoi rrjetin e brendshëm hidraulik; dekoroi mjediset e brendshme dhe të jashtme të çerdesit si dhe shpërnda lodra formuese, që ndihmojnë në procesin didaktik si dhe zhvillimin e aftësive logjike dhe matematike të fëmijëve. Në event morën pjesë z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë dhe z. Periklis Drougkas, Drejtor i Përgjithshëm i Alpha Bank Albania.



Mbyllja e vitit shkollor

Me rastin e mbylljes së vitit shkollor Drejtoria Rajonale Arsimore Tiranë organizoi Manifestimin Sportiv – Artistik të mbështetur nga BKT. Ky manifestim është kthyer në një traditë shumë të suksesshme gjatë viteve të fundit për shkollat e Tiranës.



Banka më e mirë në Shqipëri nga Euromoney

Banka Kombëtare Tregtare është rivlerësuar si "Banka më e mirë në Shqipëri për vitin 2015" nga Revista EUROMONEY bazuar në ecurinë e saj të shkëlqyer. Vlerësimi për të katërtin vit rradhazi i BKT si "Banka më e Mirë në Shqipëri", konfirmon pozicionin e saj si bankë novatore, financiarisht e fortë dhe lider në sektorin bankar shqiptar. Çmimi vjen menjëherë pas vlerësimeve të ngjashme nga dy revista të tjera prestigjioze, THE BANKER dhe EMEA Finance, të cilat vlerësuan BKT si Banka më e Mirë në Shqipëri.



Si çdo vit, Credins Bank ka zgjedhur të mbështesë fshatin SOS duke mbuluar shpenzimet e jetesës për dy fëmijë. Në vazhdimësi të ndihmës që Banka jep ndaj komunitetit, veçanërisht në sektorin e Shëndetësisë, ka qenë dhe sponsorizimi ndaj Poliklinikës së Specialiteteve Nr.3 në kryeqytet duke dhënë një ndikim të konsiderueshëm në rregullimin e mjedisëve, në të mirë të qytetarëve.

Evente të tjera sponsorizimi, janë gjithashtu në linjë me objektivat tanë për të qenë të pranishëm në ngjarjet artistike dhe kulturore të jetës në vend. Përmendim këtu mbështetjen financiare në organizimin e festës së përvitshme në Pezë në përkujtimit të konferencës mbajtur në këtë vend si dhe mbështetjen financiare për krijimin e muzeut me veshje tradicionale të grave nga krahina të ndryshme.



Crédit Agricole mbështet ditët e xhazit në Shqipëri

Gjatë muajit korrik, Banka mbështeti organizimin e "Festivalit Ndërkombëtar të Jazz-it në Shqipëri", organizuar nga shoqata "Syri Blu" dhe partnerë të tjerë. Për të katërtin vit rradhazi, ky aktivitet vazhdoi traditën e sjelljes në Tiranë dhe në qytete të tjera të Shqipërisë të argetimit në nivel botëror, nëpërmjet përcjelljes së muzikës xhaz te publikut shqiptar nga talente të ardhur nga vende të ndryshme të botës. Këtë vit festivali u zhvillua në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe Sarandë, duke i kthyer këto qytete në vende pelegrinazhi kulturor për dashamirësit e muzikës xhaz. Ashtu si në edicionet e mëparshme, gjatë festivalit, një vëmendje e veçantë iu kushtua promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe rritjes së ndërgjegjësimit lidhur me të, një çështje që gëzon rëndësi dhe përkrahje të veçantë edhe nga Banka Crédit Agricole.





Fibank sponsor kryesor i 15 vjetorit FIAA-së

FIAA kohët e fundit ka festuar 15 vjetorin e krijimit të saj. Anëtarët e komunitetit të biznesit të huaj dhe përfaqësuesit më të lartë të qeverisë shqiptare u mbledhën në Pallatin e Brigadave, në një atmosferë miqësore. Me këtë rast, anëtarëve që i kanë besuar FIAA-s për 15 vjet u shpërndanë çmime të posaçme, në prani të Kryeministrit të Shqipërisë. Fibank, si pjesëmarrësi më i ri i FIAA, ishte edhe një nga sponsorët kryesorë të kësaj ngjarje të veçantë.



Fibank Sponsor i përgjithshëm për punësim sezonal në qytetin e Korçës

Banka është kthyer tashmë në sponsorin kryesor të eventit Punësimi Sezonal të Studentëve, të organizuar nga Bashkia e Korçës. Për të katërtin vit radhazi Agjencia Fibank në qytetin e Korçës mbështeti këtë projekt të mrekullueshëm, që kryhet nga Bashkia e Korçës për punësimin sezonal të studentëve. Gjatë ceremonisë u shpërndanë certifikata pjesëmarrje për të gjithë nxënësit që ishin pjesë e kësaj ngjarje. Veprimtaria u ndoq nga kryetari i Bashkisë së Korçës, punonjësit e bashkisë, Drejtori Ekzekutiv i Fibank dhe 60 studentë të përfshirë në projekt.



Fibank në Festën e Birrës në Korçë

Fibank është sponsor zyrtar në Festa e Birrës 2015 në Korçë, nga 12- 16 gusht! Festa e Birrës në Korçë është ngjarja më e madhe e këtij lloji në Shqipëri. Brenda 5 ditëve, mbi 100.000 njerëz e vizitojnë festivalin. Numri i madh i vizitorëve vjen më së shumti për shkak të parimeve bazë të festivalit: hyrje e lirë, program i jashtëzakonshëm muzikor dhe një gamë e gjerë markash birre, vendase dhe të huaja.



Mbështetje për Qendrën e Hapur për Dialog në Kryeministri

Intesa Sanpaolo Bank Albania ishte një nga mbështetësit e projektit të koordinuar nga Banka Botërore, me financim të Bashkimit Europian për rikonstruksionin e katit të parë të Kryeministrit që vuri në shërbim të qytetarëve Qendrën e Hapur për Dialog. Nisma përkoi dhe me vizitën historike të kancelares Angela Merkel në vendin tonë.



Punësimi i personave me aftësi të kufizuara

Banka ofroi një mbështetje të përkushtuar për personat me aftësi të kufizuara në dy rrugë kryesore: së pari duke trajnuar stafin e saj përgjatë 5 sesioneve, organizuar nga fondacioni i Personave me Aftësi të Kufizuara dhe së dyti, përmes punësimit të dy personave me aftësi të kufizuara.



Bashkëpunim afatgjatë me Fakultetin e Ekonomisë

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Intesa Sanpaolo Bank Albania nënshkroi një marrëveshje me Dekanin e Fakultetit Ekonomik, sipas së cilës banka zotohet për një bashkëpunim afatgjatë me këtë institucion të arsimit të lartë, duke u dhënë mundësinë studentëve të tij të përfitojnë nga praktika e punës në një mjedis real biznesi, angazhimin e tyre në kërkime shkencore si edhe pjesëmarrjen e specialistëve të saj në leksione speciale, si ai i mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Pedrazzi me temë: “Mësime të nxjerra nga Krizat, Sfidat e Sistemit Bankar.”



Dhurata për fëmijët romë me rastin e fillimit të kopshtit

Gjatë muajit Shtator, banka në bashkëpunim me shoqatën YWCA ju bashkua nismës “Çdo Fëmi Rom në Kopësht”. Staffi i degëve të bankës Durrës, Berat, Shkodër e Lezhë u bë pjesë e kësaj nisme tërësisht vullnetare, duke përgatitur rreth 50 pako me dhurata, që përmbanin mjete mësimore didaktike si dhe veshje për fëmijët romë të moshave 2-5 vjeç të këtyre qarqeve.



Ndihmë me mjete informatike për bashkëpunëtorët në Lushnjë

Banka dhuroi pajisje informatike për Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t në Lushnjë (Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave e Ndërtimeve Informale), duke shprehur dhe një herë mbështetjen e saj për zhvillimin ekonomik të vendit përmes bashkëpunimit të të gjithë aktorëve.



A nuk është më e lehtë kur paguan vetëm një këst?

Me financimin për individë nga UBA,
të gjithë këstet mujore i paguan në një të vetëm.

www.uba.com.al

**UBA** Banka e Bashkuar
e Shqiperise
United Bank
of Albania



NGB Bank

Rinovimi i Zyrës së Regjistrimit në Vlorë
Banka NGB Shqipëri sponsorizoi rinovimin e mjediseve të Zyrës së Regjistrimit në Vlorë. Investimi ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e shërbimeve për qytetarët e rajonit të Vlorës.



Dhuratë për Drejtorinë Arsimore të Sarandës
Në funksion të misionit të tij për të mbështetur arsimin, banka dhuroi pajisje zyre për Drejtorinë Arsimore të Sarandës.



Në mbështetje të fëmijëve me talasemikë
Banka, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, mbështeti fëmijët talasemikë duke e ftuar stafin e saj për të dhuruar vullnetarisht gjak. Në Shqipëri mbi 600 fëmijë vuajnë nga talasemia dhe ata duhet të marrin gjak çdo 3 javë. Prindërit e tyre nuk mund të jenë dhurues, pasi edhe ata janë bartës të talasemisë.



Raiffeisen Bank Shqipëri nderohet me titullin "Mirënjohja e Qytetit" nga Bashkia e Gjirokastrës

Në kuadër të 10 vjetorit të përfshirjes së qytetit në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, bashkia e Gjirokastrës organizoi një seri veprimtarish me komunitetin lokal, bizneset lokale dhe organizatat jofitimprurëse që fokusohen te ruajtja e trashëgimisë së qytetit. Në një ceremoni të veçantë, Raiffeisen Bank Shqipëri u nderua me titullin "Mirënjohja e Qytetit" për kontributin e vlefshëm në sektorë të ndryshëm si: shëndeti, arsimi, kultura etj. Titulli i nderit ju dorëzua Drejtorit të Përgjithshëm Z. Christian Canacaris nga Kryetari i Bashkisë Z. Bime.



Sponsorizimi i veprimtarisë: "Ndiq ëndrrën tende"

Edhe këtë vit banka ishte sponsor gjeneral i veprimtarisë: "Ndiq ëndrrën tende", organizuar nga Shoqata e Gjymnastikës Artistike Aerobike me rastin e 20 majit, Ditës Ndërkombëtare të Jetimëve. Në këtë veprimtari sportive – artistike morën pjesë mbi 500 fëmijë të moshave 5-18 vjeç, të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, si dhe nga shtëpitë e fëmijës të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Lushnjës, Kosovës, etj. Raiffeisen Bank mbështet prej shumë vitesh Shoqatën e Gjymnastikës Artistike Aerobike e cila ka organizuar me sukses edhe këtë vit, këtë veprimtari.



Sponsor zyrtar i Albania Open 2015

Fluturimet e Lira, është një sport i cili po zhvillohet vitet e fundit në Shqipëri. Veneto Banka, për të dytin edicion rradhazi, mbështeti financiarisht Aeronautikën Shqiptare. Edhe këtë sezon ky Kampionat u zhvillua në Llogara dhe Vlorë, me pjesëmarrjen e pilotëve të ardhur nga mbarë bota.



Në mbështetje të futbollistëve të rinj
Akademia e Futbollit "Internacional" në Tiranë, sapo ka nënshkruar një kontratë bashkëpunimi me një nga ekipet e futbollit më të mirënjohura në Itali, "Udinese Calcio". Pjesë e këtij bashkëpunimi është dhe Veneto Banka, që ka investuar në ndërtimin e fushave të reja të Kompleksit Sportiv "Internacional", në Pezë-Helmës, ku do të stërviten dhe promovohen talentet e reja të sportit aq të ndjekur në Shqipëri, futbollit.

Dhurohet Kabinet Dentar për Spitalin e Himarës

Vazhdon mbështetja financiare e Veneto Banka për Bashkinë e Himarë këtë herë, së bashku me Shoqatën Humanitare nga Viçenca, "Energia e Sorrisi", duke dhuruar një kabinet dentar për Spitalin e Himarës. Ndihamat e ardhura nga Italia, së bashku me asistencën mjekësore, iu dorëzuan Kryetarit të Bashkisë Himarë, z. Jorgo Goro.



nga Zj. Monika BALLTA

Drejtuese e Departamentit të Kartave,
Divizioni i Bankingut Retail
TIRANA BANK

Akeni qëndruar ndonjëherë në dyqan prapa dikujt në radhë duke konstatuar që në portofolin e tij të ketë të paktën 5 karta? Klientët me kaq shumë karta janë të paktë, por ekspertët thonë se shumica e njerëzve kanë të paktën një kartë krediti, e ndonjëherë mund të kenë dy ose edhe tre të tilla. Është e vërtetë që kartat e kreditit janë bërë sot mjet i rëndësishëm identifikimi – për shembull, nëse duhet të rezervoni pushimet online, ju nevojitet patjetër një kartë krediti. Nëse përdoret me zgjuarsi, karta e kreditit ofron jo pak lehtësi dhe lejon kryerjen e blerjeve dhe shlyerjen e tyre deri në një muaj, pa paguar asnjë interes apo detyrime të tjera financiare. Në teori kjo tingëllon mirë, por në realitet, shumë klientë nuk janë në gjendje të përfitojnë nga këto përparësi, pasi ata mbartin gjendje debitore në kartën e kreditit nga muaji në muaj, duke paguar detyrime financiare që mund të shkojnë deri në 23 për qind. Mbajtë-

Funksionimi i kartave të kreditit

Si përfitohet prej një plani pagesash me këste



Nuk ekziston një kartë krediti e vetme që është e përshtatshme për të gjithë. Në thelb, karta më e mirë për konsumatorët është ajo që pranohet kudo ku ata blejnë dhe që ka shpenzimet më të ulta për shërbimet që ata përdorin.



si i kartës i paguan bankës ose të gjithë detyrimin, ose këste mujore dhe interesa, duke shlyer vetëm pagesën minimale të detyrueshme (që shpesh quhen dhe shpenzimet e mbartura).

Është me interes të njohim funksionimin e kartës së kreditit, si financiarisht ashtu dhe teknikisht, duke ofruar disa këshilla se si mund të zgjidhet karta e duhur e kreditit. Gjithashtu do të përshkruajmë dhe planet e ndryshme të pagesave që ofrohen për kartat e kreditit – cili plan duhet zgjedhur që i përshtatet më së miri nevojave të klientëve. Kostot dhe kushtet e një plani pagese të një karte krediti mund të bëjnë diferencën në vlerën që mund të paguajë një kartëmbajtës për mundësinë e huamarrjes që ai përfiton (çka në të vërtetë është ajo që ndodh kur përdoret një kartë krediti). Një nga faktorët kryesorë që merren parasysh për një plan pagese karte krediti është nëse ai është me normë fikse ose të ndryshueshme interesi. Fakti nëse një plan karte krediti është me normë fikse ose të ndryshueshme interesi mund të ketë një efekt të madh në shpenzimet që paguan kartëmbajtësi, për ta përdorur atë. Për shembull, nëse dikush e paguan gjithmonë të plotë detyrimin mujor, lloji më të mirë i kartës është karta

“qarkulluese”, që nuk ka tarifë vjetore dhe ofron një periudhë mospagimi për shlyerjen e detyrimit, deri në momentin final të pagesës së tij. Nëse detyrimi mujor nuk shlyhet i plotë çdo muaj, në këtë rast duhet treguar vëmendje ndaj normës periodike të interesit që aplikohet për llogaritjen e detyrimeve financiare.

Bankat që emetojnë karta krediti me plane me normë të ndryshueshme interesi përdorin tregues reference, si: norma



Përveç përfitimeve që kanë mbajtësit e kartave për krijimin e një plani të përballueshëm shlyerjeje, blerjeve me vlera më të mëdha dhe mundësië për t'i ndarë ato dhe shlyer me këste fikse mujore, edhe bankat përfitojnë nga Shërbimi i Pagesës me Këste Mujore, pasi ai çon në përdorim më të shpeshtë të kartës dhe sjell më shumë fitim, pasi transaksionet ndahen dhe balanca e mbartur rrit komisionet dhe të ardhurat nga interesi.



bazë e interesit, apo norma e bonove të thesarit tre, gjashtë apo dymbëdhjetë mujore. Kjo nuk është gjithçka për normat e ndryshueshme, ato ndryshojnë dhe mund të rrisin ose ulin detyrimet financiare të kartëmbajtësit, bazuar në ndryshimet e treguesve referencë. Nga ana tjetër, le të përqendrohemi te planet me normë fikse interesi. Kjo normë interesi mund të jetë disa pikë përqindjeje më e lartë sesa norma e ndryshueshme, por përparësia qëndron se kjo normë është e njohur që në fillim. Disa ekspertë financiarë pohojnë se, meqenëse norma fikse mund të rritet vetëm pas një njoftimi paraprak 15-ditor, ky plan nuk është aq i ndryshëm nga plani me normë të ndryshueshme, i cili është subjekt ndryshimi në çdo kohë. Ata këshillojnë që të shqyrtohen e konsiderohen të dy llojet e planeve.

Megjithatë, pavarësisht se cilin plan pagese zgjedh klienti, në çdo rast ai/ajo do të kryejnë pagesa.

Praktikisht, ekzistojnë tri lloje kartash krediti të veçanta, që njihen globalisht:

- Kartat bankare, të emetuara nga bankat (për shembull: VISA, MasterCard, etj.),
- Kartat e udhëtimit dhe argëtimit (T & E), të tilla si: American Express dhe Diners Club,
- Kartat lokale, që janë të përdorshme vetëm brenda një rrjeti dyqanesh (p.sh. shoqëritë telefonike, shoqëritë e naftës dhe supermarketet etj.)

Në tregun shqiptar klientët po familarizohen gjithashtu me atë që njihet si karta e afinitetit. Kjo lloj karte, zakonisht VISA ose MasterCard, mban edhe logon e një organizate, përveç logos së bankës. Zakonisht, mbajtësit e këtyre kartave kanë disa përfitime nga përdorimi i saj - zbritje nga pagesat e faturave telefonike, milje nga fluturimet, ose pikë me të cilat blihen mallra. Organizata që përdor një program afiniteti në bashkëpunim me një bankë, u kërkon anëtarëve të saj të përdorin karta të tilla, me synimin e vendosjes së emrit të grupit para atij të kartëmbajtësit. Përveç krijimit të besnikërisë ndaj markës, organizata ka dhe disa përfitime financiare (p.sh.: një pjesë të tarifës vjetore ose të shpenzimeve financiare, ose një përqindje të vogël komisioni për çdo transaksion, ose një kombinim të tyre) nga shoqëria e kartës

së kreditit.

Nuk ekziston një kartë krediti e vetme që është e përshtatshme për të gjithë. Në thelb, karta më e mirë për konsumatorët është ajo që pranohet kudo ku ata blejnë dhe që ka shpenzimet më të ulta për shërbimet që ata përdorin. Priorja më e fundit në tregun vendas, që po bëhet gjithnjë e më e përdorshme sidomos në dy vitet e fundit, është blerja e mallrave dhe/ose shërbimeve me këste, qoftë nëpërmjet huave konsumatore, qoftë nëpërmjet kartave të kreditit. "Hua me këste" nënkupton një hua që huamarrësi e shlyhen në këste të rregullta, e që përgjithësisht shlyhet me pagesa fikse mujore, që përfshijnë interesin dhe një pjesë të kryegjësë. Vlera e pagesës të këstit muhor varet nga një numër faktorësh përfshirë këtu çmimin e mallit, normën e interesit



Në Shqipëri ka ende rrugë të gjatë për të bërë në drejtim të edukimit rreth përdorimit të kartave në POS-e. Megjithatë, teknologjia e përparuar dhe risitë në tregun global, që po hyjnë në tregun vendas të kartave, si edhe fushatat e shpeshta për përdorimin e tyre të kryera nga bankat vendase gjatë viteve të fundit, do të japin shumë shpejt rezultate pozitive në këtë drejtim.



të aplikuar, parapagimin, afatin e huas dhe kapacitetin e shlyerjes së blerësit. Tregtari ose shitësi përfiton nëpërmjet rritjes së vëllimit të shitjeve, ndërsa huadhënësi përfiton duke aplikuar norma më të larta mbi huan me këste, në krahasim me ato që vendosen për huat e tjera.

Ndërkohë, nëse i referohemi blerjeve me kartë krediti, Shërbimi me Këste Mujore (MIS) nënkupton mundësinë që i ofrohet kartëmbajtësit që të paguajë në këste të barabarta mujore për shpenzimet e kryera për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të tjera me kartat e kreditit brenda ose jashtë ven-

dit, ose/dhe nëpërmjet internetit.

Ky lloj shërbimi mund të ofrohet në dy mënyra: së pari, nëpërmjet POS-it, aplikuar nga tregtari menjëherë në momentin e blerjes, duke e ndarë transaksionin në këste fikse, ose me intervale kohore të paracaktuara, ose sipas zgjedhjes së vetë kartëmbajtësit. Shërbimi në këtë rast ofrohet vetëm për transaksionet "brenda bankës" (on- us), për të gjitha blerjet që kryhen brenda rrjetit të tregtarëve që ka një bankë e caktuar.

Mënyra tjetër e ofrimit të këtij shërbimi fillon nga emetuesi i kartës për të gjitha blerjet në mbarë botën, qoftë me intervale kohore të paracaktuara në varësi të shumës, qoftë sipas zgjedhjes së kartëmbajtësit, pavarësisht në cilin POS përdoret karta e kreditit, duke krijuar më shumë fleksibilitet për klientin.

Ky shërbim ofrohet në Shqipëri nga Tirana Bank, në rolin e emetuesit, duke i ofruar të gjithë mbajtësve të kartës të kreditit të përfitojnë nga ky shërbim për çdo blerje që ata kryejnë, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë, duke përfshirë dhe blerjet në internet. Nëpërmjet këtij shërbimi, mbajtësi i kartës së kreditit të Tirana Bank mund t'i ndajë transaksionet e blerjeve në këste fikse, bazuar në intervale standarde prej 3, 6, 9 dhe 12 këstesh. Këstet janë të vlefshme për blerjet në shumën që shkojnë deri në 500.000 lekë.

Përveç përfitimeve që kanë kartëmbajtësit për krijimin e një plani të përbalueshëm shlyerjeje, edhe bankat përfitojnë nga Shërbimi i Pagesës me Këste Mujore, pasi ai çon në përdorim më të shpeshtë të kartës dhe sjell më shumë fitim, pasi transaksionet ndahen dhe balanca e mbartur rrit komisionet dhe të ardhurat nga interesi. Nga ana tjetër, kjo është një lehtësi që i shtyn kartëmbajtësit drejt blerjeve më të mëdha, pasi ata kanë mundësi t'i ndajnë dhe t'i paguajnë me këste fikse.

Në Shqipëri ka ende rrugë të gjatë për të bërë në drejtim të edukimit rreth përdorimit të kartave në POS-e. Megjithatë, teknologjia e përparuar dhe risitë në tregun global, që po hyjnë në tregun vendas të kartave, si edhe fushatat e shpeshta për përdorimin e tyre të kryera nga bankat vendase gjatë viteve të fundit, do të japin shumë shpejt rezultate pozitive në këtë drejtim.

DEPOZITA 5

DEPOZITA ME AFAT

Viti i **5**

ÇDO VIT QË KALON,
MË SHUMË PËRFITON!



 **UNIONBANK**
Banka që dua

Përfitoni depozitën me afat **5** vjeçar,
ku interesi rritet vit pas viti!

www.unionbank.al ☎ 0800 0800



nga **Z. Roberto RUOZI**

Professor emeritus
UNIVERSITÀ BOCCONI DI MILANO

Zhvillimi ekonomik dhe social kërkon kudo dhe në çdo kohë, një rrjet solid infrastrukturash, realizimi i të cilit është përgjegjësi e administratave publike qendrore dhe lokale të vendeve të veçanta. Ky realizim kërkon disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme financiare, që zakonisht duhet të jenë në një nivel të konsiderueshëm, duke pasur parasysh vlerën e lartë të rrjeteve të lartpërmendura. Këto burime duhet të kenë karakteristika teknike specifike edhe për shkak se investimet në infrastrukturë zgjasin në kohë dhe jo gjithmonë gjenerojnë fondet e nevojshme për të paguar borxhet e tyre. Problemi është më kompleks në vendet në zhvillim, në të cilat financat publike disponojnë burime më të pakta se sa nevojat aktuale. Hendeku, kur është e mundur, mbulohet duke iu drejtuar borxhit ose burimeve financiare të jashtme. Shteti mund të emetojë obligacione, por gjithashtu mund të marrë hua apo injektim kapitali

Banka Aziatike e Investimeve në Infrastrukturë (AIIB)

Një faktor i ri për zhvillim ekonomik rajonal e global



Pjesëmarrja në një klub (siç është dhe AIIB) është sigurisht e dobishme, me kusht që kosto relative të jetë e kufizuar dhe të ekzistojë vullneti politik dhe kapaciteti teknik për të qenë, nëse jo protagonistë, të paktën vëzhgues të vëmendshëm të asaj që ndodh në zonat e financuara dhe për të pasur mundësinë e reagimit, sipas nevojës.



me destinacione të veçanta nga institucione financiare të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, publike ose private.

Në rastet e këtyre të fundit, huadhënësit - në zgjedhjen e vendeve në të cilat do investohet, dhe në zgjedhjen e infrastrukturave specifike që do të financohen brenda vendeve, - luajnë në të njëjtën kohë një funksion financiar dhe një funksion politik. Faktikisht, jo rrallë këto zgjedhje nxisin marrëdhënie pozitive apo negative politike me vendet financuese e me ato jo financuese dhe kushtëzojnë zhvillimin ekonomik dhe social lokal, që mund të shkaktojë kthime të ndryshme edhe për huadhënësit dhe vendet e tyre. Mendoni, për shembull, kushtëzimet e drejtpërdrejta apo të tërthorta, që kontratat e huadhënies ose injektimit të kapitalit mund të ushtrojnë mbi modalitetet e ndërtimit dhe menaxhimit të infrastrukturave (si në zgjedhjen e furnizuesit).

Në kontekstin e huadhënësve institucionalë të infrastrukturave për zhvillim, në dekadat e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore morën rëndësi të veçantë e ashtuquajtura Banka Botërore dhe, për Europën Perëndimore, Banka Evropiane e Investimeve. Në vitet e fundit, përsëri për arsye financiare dhe politike, u krijua

një bankë për investime, për të vepruar edhe në vendet e ish-bloku komunist në Europën Qendrore dhe Lindore. Historia e këtyre institucioneve - dhe të tjerave të ngjashme me to - luhet midis periudhave të suksesit dhe relativisht



Duhet pasur parasysh se veprimtaria në praktikë e AIIB-së ende nuk ka filluar dhe se shumë nga përgjigjet e pyetjeve të shtruar mund të ndryshojnë, ose të shpjegohen më mirë, bazuar në faktet konkrete. Vetëm pas disa vitesh mund të bëhet një vlerësim i parë i kësaj nisme, mbi bazën e të cilit mund të merret një vendim më i informuar.



stanjacionit. Në vitet e fundit veprimtaria e tyre ka pësuar rënie, edhe pse kërkesa për financimin e infrastrukturave nuk është zvogëluar aspak, si në vendet e zhvilluara dhe në ato në zhvillim. Në ekonomitë e zhvilluara infrastrukturat e

reja janë të nevojshme për të menaxhuar ndryshimet strukturore që kërkon globalizimi i ekonomive dhe evoluimi i shoqëri; në vendet në zhvillim ato janë të domosdoshme për të vijuar zhvillimin klasik ekonomik dhe social dhe për të rritur nivelin e mirëqenies kolektive të popullatës.

Ndërkohë, për më tepër ekuilibrat ndërkombëtarë ekonomikë, financiarë dhe politikë kanë ndryshuar dhe në skenën ndërkombëtare kontinenti aziatik ka marrë një peshë më të madhe. Bëhet fjalë për një kontinent jashtëzakonisht heterogjen, në të cilin bashkëjetojnë vende të forta dhe të dobëta, si në kërkesa ashtu dhe në disponibilitet të burimeve. Dimensionet e përgjithshme të secilit prej tyre bëjnë që për ndërtimin e infrastrukturave të nevojiten burime, që nuk janë më brenda mundësive të financuesve klasikë shumëpalësh, si ata të përmendur më lart.

Kështu, nuk ishte çudi që, nën drejtimin e fuqisë më të madhe aziatike, Republikës Popullore të Kinës, u themelua në Pekin në vitin 2014, Banka Aziatike e Investimeve në Infrastrukturë (AIIB). Sipas Nenit 1 të Statutit të saj, objektivi i AIIB është: a) favorizimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, krijimi i pasurisë dhe përmirësimi i lidhjeve ndërmjet infrastrukturave në Azi, duke investuar në këto infrastruktura dhe sektorë të tjerë produktivë; dhe b) promovimi i bashkëpunimit dhe partneritetit rajonal, për të adresuar mundësitë e zhvillimit në koordinim me institucionet e tjera dypalëshe ose shumëpalëshe të zhvillimit. Për të arritur këto objektiva, sipas Nenit 2 të Statutit, AIIB mund të investojë kryesisht në projektet e zhvillimit, publike ose private, qoftë duke investuar në kapital ose duke dhënë hua.

Aktualisht në kapitalin e AIIB-së marrin pjesë 57 shtete, ndër të cilat dhe rreth njëzet shtete jo-aziatike, përfshirë dhe Italinë. Kështu, është veçanërisht e rëndësishme (sidomos në këndvështrim politik) pjesëmarrja e Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Australisë dhe Rusisë, ndërsa vihet re mungesa e Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë, të cilat nuk e kanë vlerësuar krijimin e AIIB-së. Shtrohet pyetja nëse këto vende do të ndryshojnë mendje gjatë rrugës, por në



këtë moment është e pamundur të jepet një përgjigje realiste për këtë pyetje. Një rol të rëndësishëm do të luajë mënyra e veprimit të AIIB-së dhe çfarë e sa veprimtari do të jetë në gjendje të kryejë. Pjesëmarrja e vendeve jo-aziatike është me siguri e motivuar edhe nga arsytet politike të përmendura. Këto vende e njohin mirë rëndësinë e kontinentit aziatik dhe kuptojnë se pjesëmarrja në këtë lloj klubi, siç është banka e re, mund të lehtësojë dialogun me të gjithë vendet e rajonit. Duke marrë pjesë në kapital këto vende mendojnë se mund të kenë informacion të besueshëm dhe në kohë, lidhur me shumë projekte zhvillimi, të cilat do të realizohen në Azi. Ky informacion mund të përdoret edhe në favor të tyre.

Për sa më sipër dhe me instrumentet financiare që duhet të jetë në gjendje të mbledhë nga vendet e asociuara, AIIB-ja mund të bëhet një alternativë e përshtatshme, në krahasim me bankat



Aktualisht në kapitalin e AIIB-së marrin pjesë 57 shtete, ndër të cilat dhe rreth njëzet shtete jo-aziatike, përfshirë dhe Italinë. Kështu, është veçanërisht e rëndësishme (sidomos në këndvështrim politik) pjesëmarrja e Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Australisë dhe Rusisë, ndërsa vihet re mungesa e Shteteve të Bashkuara dhe Japonisë, të cilat nuk e kanë vlerësuar krijimin e AIIB-së.



e tjera ndërkombëtare për zhvillim të përmendura më lart, e veçanërisht në lidhje me Bankën Botërore. Ndërkohë, nuk duhet të ketë marrëdhënie as plotësuese dhe as konkurruese me Fondin Monetar Ndërkombëtar, për shkak të dallimeve strukturore që duhet të karakterizojnë veprimtaritë e tyre respektive. Në fakt FMN duhet të vazhdojë të operojë në afat të shkurtër, ndërsa për përkufizim AIIB-ja duhet të veprojë vetëm në periudhë afatgjatë.

Së fundi, mund të lindë pyetja nëse kjo nismë mund të jetë me interes për shtetet e Ballkanit, si dhe për Shqipërinë. Sipas Nenit 1 të Statutit të AIIB, këto vende nuk janë ndër ato që përfitojnë nga ndërhyrjet e Bankës, të kufizuara në Azi, sipas përcaktimeve nga Kombet e Bashkuara. Ndërkohë ato mund të kenë përfitime të tërthorta nga pjesëmarrja në kapitalin e AIIB-së, siç u shqyrtuan më sipër e për të cilat dua vetëm të rikujtoj që, pjesëmarrja në një klub është sigurisht e dobishme, me kusht që kosto relative të jetë e kufizuar dhe të ekzistojë vullneti politik dhe kapaciteti teknik për të qenë, nëse jo protagonistë, të paktën vëzhgues të vëmendshëm të asaj që ndodh në zonat e financuara dhe për të pasur mundësinë e reagimit, sipas nevojës.

Në çdo rast, duhet pasur parasysh se veprimtaria në praktikë e AIIB-së ende nuk ka filluar dhe se shumë nga përgjigjet e pyetjeve të shtruar mund të ndryshojnë, ose të shpjegohen më mirë, bazuar në faktet konkrete. Vetëm pas disa vitesh mund të bëhet një vlerësim i parë i kësaj nisme, mbi bazën e të cilit mund të merret një vendim më i informuar.

Kontributi i biznesit në edukimin e sipërmarrësve të së ardhmes

Junior Achievement (JA) është një program shkollor, i cili me metodologjinë e tij praktike iu përcjell të rinjve njohuri mbi sipërmarrjen, i përgatit dhe i frymëzon ata për të qenë të suksesshëm në tregun e ekonomisë globale. Ky program u mëson të rinjve si të krijojnë biznese, të cilat gjenerojnë vende të reja pune. Të rinjtë investojnë kështu në krijimin e vlerave, aftësive, qëndrimeve, tepër të domosdoshme për të siguruar, rritur dhe menaxhuar të ardhurat e tyre. Zbatimi i programit Junior Achievement në Shqipëri mundësohet si një investim i drejtpërdrejt i Fondacionit Shqiptaro – Amerikan për Zhvillim (AADF). Falë mbështetjes strategjike të AADF dhe bashkëpunimit institucional me Ministrinë së Arsimit dhe Sportit, në vitin e katërt të zbatimit, JA është shtrirë në 170 shkolla të mesme (të përgjithshme dhe profesionale), në të gjithë Shqipërinë.

Edukimi për sipërmarrjen merr një vlerë të shtuar kur biznesi dhe sipërmarrësit përfshihen në procesin e formimit të brezit të ri. Nëpërmjet kontributit të drejtpërdrejt në organizimin e nismave dhe veprimtarive të ndërmarra, biznesi lë gjurmë në fuqizimin e të rinjve me dije dhe përvojë, të cilën do ta mbartin gjatë gjithë jetës. Pjesëmarrja e vullnetarëve profesionistë nga fusha e biznesit në procesin e mësimdhënies shërben jo vetëm si burim frymëzimi, por edhe si një model suksesi, që orienton të rinjtë në vendosjen e piketave drejt suksesit. Ata kanë fatin të jenë “kujdestarë” dhe pse jo “rojtare” të nismave dhe eksperiencave të para rinore. Institucionet financiare kapilare dhe sistemi bankar në tërësi, luajnë një rol thelbësor në realizimin me sukses të nismave të JA, jo vetëm përmes kapaciteteve intelektuale dhe profesionale, (kujdestarët e biznesit në klasë, drejtues – pritës institucionalë të nxënësve të shkëlqyer, anëtarë jurie në konkurset

JA, kujdestarë – këshillues në kampin e inovacionit), por edhe përmes mbështetjes financiare, si një investim i biznesit në edukimin e brezit të ri. Banka Raiffeisen dhe Banka Credins kanë mbështetur dhe mundësuar procesin e kujdestarisë në më shumë se 50 shkolla të mesme, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke sjellë në klasë specialistë të suksesshëm.

Për herë të parë në historinë e arsimit

Pjesëmarrja e vullnetarëve profesionistë nga fusha e biznesit në procesin e mësimdhënies shërben jo vetëm si burim frymëzimi, por edhe si një model suksesi, që orienton të rinjtë në vendosjen e piketave drejt suksesit.

shqiptar, JA solli si kulturë procesin e kujdestarisë online, ku nëpërmjet teknologjisë SKYPE, kujdestarët e biznesit kanë mundësi të realizojnë misionin e tyre në shkolla periferike, ku mundësia e pjesëmarrjes fizike të tyre është e pamundur. Pricewaterhouse Coopers, Tirana International Airport & Vodafone kanë bërë të mundur pajisjen e 11 shkollave me minilaboratorë, duke mundësuar kështu qasje të drejtpërdrejtë të biznesit në shkolla, duke thyer barrierat fizike.

Neve në JA besojmë në potencialin pa kufi të të rinjve, ndaj edhe ndajmë pasionin e tyre për ekselencën, respektojmë talentin dhe krijimtarinë, festojmë integritetin dhe çiltërsinë e tyre dhe jemi të vendosur t'u krijojmë mundësi, në mënyrë që ata të rriten dhe të zhvillohen si të rinj të suksesshëm.

Junior Achievement fuqizon të rinjtë shqiptarë për të zotëruar suksesin e tyre!





PËR PROFESIONISTËT E LIRË BANKA QË BESON TEK JU.

Veneto Banka është tashmë partneri më i mirë për të gjithë Avokatët, Noterët dhe Kontabilistët duke ju ofruar:

- Overdraft pa kolateral
- Mundësi financimi deri në 60 muaj
- Kartë Debiti VISA Business

Veneto Banka.
Banka që beson tek ju.

Tel. +355 (0) 4 2280555
www.venetobanka.al

 **VENETO BANKA**
GRUPPO VENETO BANCA

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Njerëzit, Planeti, Mirëqenia



Çfarë janë OZHQ (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm)?

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) është një grup prej 17 objektivash të cilat shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara do t'i përdorin për të formuluar politikat e tyre në 15 vitet e ardhshme, me qëllim promovimin e paqes, mirëqenien dhe mbrojtjen e m jedisit. Objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm janë pasuese dhe pasqyrohen si zgjerim i fushave të Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit (Millenium Development Goals), të cilat janë miratuar nga qeveritë në ndërrimin e mijëvjeçarit dhe skadojnë në fund të këtij viti.

Çfarë kanë ndryshe OZHQ-të?

OZHQ-të ndërmarrin një qasje më të thelluar drejt zhvillimit global duke: (i) kërkuar të adresojnë disa nga shkaqet kryesore të varfërisë; (ii) themeluar një grup të zgjeruar qëllimesh dhe objektivash (si për shembull: për të drejtat e njeriut, aspektin gjinor dhe klimën); dhe (iii) përcaktuar strukturat për të mbështetur zbatimin efektiv.

Kombet e Bashkuara (KB) udhëhoqën programin më të gjerë të konsultimit mes qeverive, bizneseve dhe shoqërisë civile në historinë e saj për të informuar rreth asaj çfarë OZHQ-të duhet të përfshinin. ICC luajti një rol drejtues në këto konsultime globale, si pika qendrore zyrtare e biznesit gjatë negociimeve të KB dhe si Kordinator i Aleancës Globale të Biznesit për Post 2015.

17 Objektivat e reja Globale

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm u prezantuan dhe u miratuan në Samitin e KB të mbajtur në New York në datat 25-27 shtator.

Objektivat përfshijnë, fusha që variojnë nga dhënia fund e varfërisë ekstreme dhe uria te trajtimi i ndryshimit të klimës. Këto objektivat përfshijnë 169 synime. Aktualisht po zhvillohet një strukturë matëse globale, e përbërë nga 120 tregues shoqëruar që do të përcaktojnë rezultate specifike dhe do të mundësojnë matjen e progresit.

OZHQ do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2016 dhe do të jenë të vlefshme deri në fund të vitit 2030.

Financimi i Objektivave: Pyetja 1 trilion \$

Një studim i KB ka përcaktuar 8-10 trilion dollarë amerikanë për financim e zbatimit të këtyre objektivave në nivel global. Në konferencën e fundit të Kombeve të Bashkuara mbi Financimin për Zhvillim të mbajtur në Addis Ababa, u miratua një paketë financimi gjithëpërfshirëse në mbështetje të zbatimit të OZHQ.

Përveç financimit nga qeveritë, marrëveshja e re vendos në një fokus të rëndësishëm mobilizimin e burimeve të sektorit privat, duke përfshirë partneritetet "inovative" publik-privat .

Rritja e fokusit të sektorit privat...

Angazhimi i sektorit privat do të jetë themelor për suksesin e OZHQ. Përveç nevojës për të mobilizuar kapitalin e sektorit privat, objektivat e reja vendosin një theks në promovimin e tregtisë, si një motor rritjeje dhe inkurajojnë kompanitë të adoptojnë modelet e biznesit të qëndrueshëm. Tashmë njihet se sektori privat do të luajë një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave, për të matur progresin kundrejt raportit synim/tregues të OZHQ.

AAB Aktivitete



Mëngjes pune me përfaqësues të mediave, 17 shtator 2015

Në kuadër të ndërtimit të urave të komunikimit me mediat, me qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe forcimin e një bashkëpunimi efektiv, AAB organizoi një mëngjes pune me anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të AAB-së dhe përfaqësuesve të medias. Gjatë këtij takimi joformal, pjesëmarrësit diskutuan për fuqinë e medias në opinionin publik si dhe për çështjet të rëndësishme, që lidhen me sektorin bankar, dhe ranë dakord se, një komunikim më i mirë e më efektiv mes të dy palëve do të çojë në informim më të mirë të publikut.



Udhëtim trajnues për gazetarë ekonomikë, 3-4 tetor 2015

Në vijim të aktivitetit me përfaqësues të mediave, AAB organizoi një udhëtim trajnues në Vlorë. Kësaj nisme i'u bashkuan 13 gazetarë ekonomikë të mediave të ndryshme si: Agjencia Telegrafike Shqipëtare (ATSH); Agjencia Kombëtare e Lajmeve (NOA); Revista Monitor; Shekulli; Shqip; Top Channel; Top News; TVSH dhe Vizion Plus, të cilët patën mundësi të zgjerojnë të kuptuarit e çështjeve financiare dhe bankare në sajë të prezantimeve dhe diskutimeve me përfaqësues nga BKT, Fibank, Tirana Bank dhe Procredit Bank. Dita e dytë vijoi me një udhëtim në ishullin e Sazanit dhe ndalim për drekë në Karaburun, ku në një mjedis të ngrohtë dhe miqësor gazetarët dhe bankierët kishin mundësi të mëtejshme për të diskutuar.

Trajnime

"Pagesat dhe Menaxhimi i CASH-it – përmes përdorimit të mesazheve FIN", 6-17 shtator 2015

AAB, në bashkëpunim me SWIFT, organizoi për herë të parë në Shqipëri, trajnimin me temë: "Pagesat dhe Menaxhimi i Cash-it – përmes përdorimit të mesazheve FIN". Trajnimi u ndoq nga 12 përfaqësues të bankave tregtare dhe bankave qendrore të Shqipërisë dhe Kosovës.



Zhvillimi i produktit, 21-22 shtator 2015

Kursi i trajnimit mbuloi një gamë të gjerë temash, të tilla si: procesi i serisë së fazave për zhvillimin e produktit të ri; faktorët kritikë të suksesit në nivel projekt; ndikimi i klimës dhe kulturës së duhur për inovacionin dhe roli i drejtimit të lartë në ecurinë e produktit të ri të biznesit; strategjitë e ciklit të jetës së produktit, etj. Trajnimi u drejtua nga Cüneyt Eriğüç dhe u ndoq nga 4 pjesëmarrës të bankave anëtare.



Ekselenca në Shitje , 22-23 shtator 2015

AAB, në bashkëpunim me WIFI Albania organizuan një trajnim mbi shitjet, të drejtuar nga trajnuesi ndërkombëtar Eric Molin dhe u ndoq nga 11 pjesëmarrës nga bankat, anëtare të AAB-së, të Kosovës dhe nga institucionet e tjera financiare. Kursi ishte i projektuar për menaxherët e shitjeve, të cilët duan të përsosin teknikat e planifikimit të shitjeve, të ndërtojnë aftësitë e tyre të lidhshpimit, të bëhen vendim-marrës, motivues, komunikues dhe këshillues më të fuqishëm.



Edukimi Financiar

Projekti i videove informative "*Banka ime*" ka për qëllim të japë informacion të thjeshtë për klientët të rinj dhe ekzistues të bankave.

7 videot e para mund ti gjeni në faqen zyrtare të AAB-së, si dhe në profilet e AAB-së në rrjetet sociale.



KARTAT BANKARE
DHJETOR 2014



METODAT E PAGESAVE
DHJETOR 2014



KREDIA KONSUMATORE
MARS 2015



ÇFARË ËSHTË KREDIA HIPOTEKARE
KORRIK 2015



NORMA E INTERESIT DHE "FORMIMI" I SAJ
KORRIK 2015



SIGURIMI I DEPOZITAVE
GUSHT 2015



KOMISIONET BANKARE
TETOR 2015

